

# GËZUAR VITIN E RI 2026!

FEDERATA SHQIPTARE E VETERANËVE TË LUFTRAVE PËR LIRI E PAVARËSI TË POPULLIT SHQIPTAR

# VETERANI

GAZETË PERIODIKE. NR. 1(450)

JANAR 2026

ÇMIMI: 30 LEKË

Drejtor: MUHARREM GJOKA; Kryeredaktor: HALIL RAMA ; Zv/Kryeredaktor: SAKIP CAMI; website: www.VETERANIJOBVL.ORG

## REFLEKSIONE

**MUSINE KOKALARI**  
MODELI I FJALËS SË LIRË TË INTELEKTUALIT

**SHPENDI TOPOLLAJ**



**FAQE 8-9**

## OPINION

**HISTORIA**  
ËSHTË SHKRUAR ME GJAK, ATË NUK MUND TA SHTREMBËROJNË PSEUDOHI-STORIANËT

**Nga Sakip CAMI**



**FAQE 4**

## PROZE POETIKE

**KURI**  
DHASHË DORËN TATJANA PARLLAKUT

**Nga Aqif PUCA**



**FAQE 13**

**REPORTAZH/ Nga persekutimi komunist te nderimi në SHBA, saga e familjes Boletini**

# PËRJETËSIA E HEROIT, RRUGA “ISA BOLETINI” NË NEW YORK

## EDITORIAL

**SAKRIFICAT**  
SUBLIME PËR ÇËSHTJEN KOMBËTARE

**Halil Rama - Mjeshtër i Madh**

Ishte kënaqësi për mua që në atë tubim të rëndësishëm të shikoja që e pranishme ishte edhe njëra nga vajzat e mikut tim Enver Dajçi, si një ndër pasardhëset e familjes Boletini, gazetarja dhe veprimtarja e njohur e komunitetit shqiptar në SHBA, Zj. Mimoza Dajçi, e cila me penën e saj është e vetmja femër shqiptare që ka shkruajtur gjatë, gjerë e vazhdimisht për jetën dhe sakrificat sublime të Isa Boletinit e familjes Boletini për çështjen kombëtare.

**FAQE 2-3**

## REFLEKSIONE

**LIBRI “DEKODIMI**  
KRIMEVE” I BASHKIM DAUTI HISARIT

**Nga Kol.Trifon LLUPO**

**FAQE 12**

## HOMAZH

**PROFESOR XHEVAT**  
KOSHI, PERSONALITET I SHQUAR I ARSIMIT NË GJAKOVË E KOSOVË

**Nga Bashkim HISARI**

**FAQE 12**



• *Isa Boletini lindi më 15 janar 1864 në Mitrovicë, ai u bë një nga prijësit kryesorë të shqiptarëve të Kosovës në luftrat e tyre kundër pushtuesve osmanë, serbo-malazezë dhe grekë. Një nga ngjarjet më të njohura të jetës së tij, është pjesëmarrja në ngritjen e Flamurit në Vlorë në nëntorin e 1912-ës, ku Ismail Qemali shpalli Pavarësinë e Shqipërisë....*

**FAQE 13**

## HOMAZH

**KOLONEL SHPËTIM KALO, KUADRI USHTARAK MODEL I USHTRISË SHQIPTARE**

**Kolonel ALI DEMUSHI**

**FAQE 6**

## HYSEN DIZDARI NJË LIBËR ME VLERA TË LARTA ATDHETARIE

**“GJERGJ KASTRIOTI SKËNDERBEU NË**  
PULLAT SHQIPTARE 1913 – 2023”



*“Jam nisur të mbetem vërtet një kabanë,  
Aspak s’tingëlloj e s’gjëmoj po s’më ranë.  
Më bini, ju lutem, përherë e ngaherë,  
Në doni prej meje gjëmim e poterë.”*

*Dritero Agolli. Poezia “Lutja e kabanës”*

**Kadri Tarelli**

**FAQE 14**

## 82 VJETORI

**RRUGA E LAVDISHME**  
E BRIGADAVE TË V-të DHE VI-të

**FAQE 5-6**

## KËNGËT PARTIZANE

**FATMIR GJATA,**  
SHKRIMTARI ME GJURMË TË PASHLYERA NË LETËRSINË SHQIPE

**FAQE 15**

## IN MEMORIAM

**ELHAM ELEZAJ DËSH-**  
MORI LAB QË SHKROI HISTORI KRENARIE NË POLICINË E SHTETIT

**Prof. Asoc. Dr. Zaho GOLEMI**

**FAQE 10-11**

## SIMPOZIUMI

**PUKË, PËRKUJTOHET**  
DËSHMORI I ATDHET ALI BYTYÇI

**Xhemal Meçi, Mjeshtër i Madh**

**FAQE 7**

## REPORTAZH

## Nga persekutimi komunist te nderimi në SHBA, saga e familjes Boletini



Belind Këlliçi, Mimoza Dajçi dhe  
NYC Councilman David Carr



# Përjetësia e heroit, rruga “Isa Boletini” në New York

• Duke ndjekur Ditën e Inaugurimit të Rrugës “Isa Boletini” në Staten Island, New York - 30 Nentor, 2025

**Halil Rama - Mjeshtër i Madh**

I.

Në pamundësi për të marrë pjesë fizikisht në inaugurimin e Rrugës “Isa Boletini” në Staten Island, së bashku me familjen time, mundëm ta ndiqim nëpërmjet televizorit në banesën tonë në Tiranë. U gëzova shumë, vura re se kishin marrë pjesë personalitete të shumta amerikane, shqiptarë nga Shqipëria, Kosova dhe Shkupi.

Organizatori kryesor i asaj ceremonie ishte Naser Nika, banues në Staten Island, i cili në bashkëpunim edhe me shoqata të tjera dhe përfaqësues të politikës amerikane, arritën këtë ditë suksesi, ku emri i Heroit Isa Boletini të zerë vend përkrah firmëtarit të Pavarësisë së Shqipërisë Ismail Qemali në një nga rrugët në New York.

Ishte kënaqësi për mua që në atë tubim të rëndësishëm të shikoja që e pranishme ishte edhe njëra nga vajzat e mikut tim Enver Dajçi, si një ndër pasardhësit e familjes Boletini, gazetarja dhe veprimtarja e njohur e komunitetit shqiptar në SHBA, Zj. Mimoza Dajçi, e cila me penën e saj është e vetmja femër shqiptare që ka shkruajtur gjatë, gjerë e vazhdimisht për jetën dhe sakrificat sublime të Isa Boletinit e familjes Boletini për çështjen kombëtare.

Edhe pse moti ishte i keq me shi, pata mundësi të flas direkt me Mimozën në telefon, e cila i ndihet falenderuese Naser Nikës, Këshilltarit të Bashkisë në Neë York, David Carr, si dhe të gjithë shoqatave që morën iniciativën për realizimin e vendosjes së emrit të heroit tonë kombëtar Isa Boletini përkrah plakut të urtë e udhëheqësit të Pavarësisë së Shqipërisë Ismail Qemali. Bisedova pak me Mimozën e cila ndodhej atje së bashku me vajzën e saj, violinisten e talentuar Merlinin. U ndjeva krenar për to, që po ecin në rrugën e patriotizmit dhe humanizmit, njëjtë si paraardhësit e familjes së tyre.

## KRIMET NDAJ SHQIPTARËVE

Mimoza më citoi edhe një shprehje të nënshkruesit të Pavarësisë së Shqipërisë Ismail Qemali, me rastin e mbërritjes së Isa Boletinit në Vlorë: “I madhi Isa, luftërat tuaja ishin bazë e përpjekjeve të mia për Pavarësinë e Shqipërisë”.

“Unë jam këtu sot - tha Zj. Dajçi - për t'i dëshmuar shkjaut, serbit se gjaku i Boletinëve është gjallë dhe nuk i harron kurrë krimet që historikisht kanë kryer ndaj popullsisë së pafajshme shqiptare në Kosovë. Krime që vazhduan edhe më pas, ku mes të vrarëve dhe të masakruarve mbetën gra, fëmijë e pleq, u vranë djemtë më të mirë të kombit, shqiptaro - amerikanë, vëllezërit Bytyci që edhe ata sot i kujto-

jmë me respekt. Nga makineria serbe në Kosovë u malltrajtuat dhe u përdhunuan mbi 20 mijë gra e vajza shqiptare.

Gjithashtu - tha ajo - Falenderoj mbesat dhe nipin e Isa Boletinit Ariana Hoxhën, Arieta dhe Armend Muratin si pasardhës të denjë të Heroit Isa Boletini, të cilët vazhdojnë të ngrenë lart figurën emblematike të Gjeneralit me qeleshe të bardhë Isa Boletini në arenën kombëtare dhe ndërkombëtare”.

Isa Boletini lindi më 15 janar 1864 në Mitrovicë, ai u bë një nga prijësit kryesorë të shqiptarëve të Kosovës në luftat e tyre kundër pushtuesve osmanë, serbo-malazezë dhe grekë. Një nga ngjarjet më të njohura të jetës së tij, është pjesëmarrja në ngritjen e Flamurit në Vlorë në nëntorin e 1912-ës, ku Ismail Qemali shpalli Pavarësinë e Shqipërisë. Isa Boletini u vra nga forcat serbo-malazeze të Gjeneralit Vukoviq, teksa ishte duke kaluar në urën e Ribnicës në qytetin e Podgoricës. Bashkë me Isa Boletinin, atë ditë u vranë dhe shtatë pjestarë nga familja e tij.

## KTHIMI I ESHTRAVE

Pas vrasjes së Heroit Isa Boletini, djemve, nipave dhe luftëtarëve të tij në Podgoricë më 23 Janar 1916, eshtrat e tyre qëndruan më tepër se 80-të vite në varrezat e Malit të Zi. Që nga viti 1978, autoritet Kosovare filluan përpjekjet e para për tërheqjen eshtrave të Isa Boletinit dhe luftëtarëve të tjerë në Podgoricë dhe për t'i rivarrosur ato në vendin e lindjes në Kosovë, ku një nga këmbëngulësit e mëdhenj që eshtrat e Isa Boletinit

të mbërrinin nga Mali i Zi në Kosovë, ka qenë edhe Presidenti i Kosovës Ibrahim Rugova.

Meritë e veçantë për këtë i takon edhe ish Kryetarit të Bashkësisë Islame në Mal të Zi, Idriz Demiraj, i cili njoftoi familjarët në Mitrovicë për marrjen e eshtrave të Isa Boletinit.

Si dhe nipit të Isa Boletinit, Remzi Muratit, djalit të Shehides, vazjës së Isa Boletinit, që në maj të vitit 1998 mes reziqeve të mëdha si amanet i nënës së tij Shehides, arriti të sjellë eshtrat e Isës dhe luftëtarëve të tjerë në Kosovë.

Si rezultat i politikës të ndjekur nga Beogradi dhe Tirana komuniste, që pas vrasjes së Isës nga familja Boletini u vranë apo ekzekutuan 15 vetë, dhjetë të tjerë kaluan vite të tëra në burgje dhe internime politike duke vuajtur dënimet nëpër burgjet e tmerrshme të Serbisë dhe Shqipërisë, ku mes tyre mund të veçoj edhe babanë e Mimoza Dajçit, që e kam njohur personalisht dhe ruaj konsideratën dhe respektin më të veçantë për të, si patriot, intelektual, zotëruar i shtatë gjuhëve të huaja, ish i burgosur politik në Shqipëri dhe xhaxhain e saj pushkatuar pa gjyq nga forcat sllavo komuniste në Prizren në vitin 1944.

Represioni dhe hakmarrja e sllavo-komunistëve ndaj familjes së njohur të Isa Boletinit filloi që në nëntorin e vitit 1943, kur komunistët në Shkodër vranë nënkolonel Adem Boletinin, djalin e tretë të Isës, i cili kishte mbaruar Akademinë Ushtarake në Vjenë.

(Vijon në faqen 3)



**REPORTAZH**

**• Ky tubim i organizuar nga Naser Nika, banues në Staten Island, u ndoq gjithashtu nga afër nga deputeti i PD-së, Belind Këllici, ambasadorët shqiptarë Suela Janina dhe Blerim Reka; ish diplomati Mal Berisha, gazetari Beqir Sina - ish i persekutuar politik nga regjimi komunist në Shqipëri, gazetari Halil Mula etj...**

(Vijon nga faqja 2)

**PERSEKUTIMI KOMUNIST**

Pas kësaj, si në Mitrovicë ku jetonte pjesa më e madhe e Boletinëve, ashtu edhe në Shqipëri, familja Boletini u gjend nën një persekucion të egër dhe barbar nga regjimet komuniste të Titos dhe të Enver Hoxhës. Regjimi komunist i Enver Hoxhës ndaj familjes së Boletinëve ndoqi po atë politikë të cilën kishte ndjekur për shumë vjet regjimi komunist i Titos. Në një material publicistik, Mimoza Dajçi shkruan: “Kur im atë kryente një pjesë të dënimit të tij si i ish i burgosur politik në burgun e Ballshit në Shqipëri, atë kohë në atë burg vuante dënimin si i burgosur politik edhe nipi i gjeneralit Vukoviq, që kishte vrrarë Isa Boletinin. Svetko, kështu quhej nipi i Vukoviqit, ishte ankuar në drejtorinë e atij burgu, që të largonin nga ai burg Enver Dajçin, me pretekstin se jeta e tij nuk ishte e sigurtë aty nga nipi i Isa Boletinit, Enver Dajçi, i cili mund të hakmerrej ndaj atij. Kur babai im dëgjoi këto fjalë - shkruan Mimoza - si një personalitet me integritet të lartë intelektual dhe me gjakftohtësi të plotë përgjigjet: “Svetko për mua, të qëndrojë i qetë, pasi unë nuk jam hakmarrës. Kur xhaxhai i tij Vukoviq vrau Isa Boletinin, Svetko nuk kishte lindur ende, dhe nuk ka asnjë faj për atë krim, që do ta dënojë koha”. Dhe vërtetë ashtu ndodhi, Svetko doli gjallë nga ai burg, pa asnjë kërcënim për jetën nga im atë, ndërsa babain tim e izoluan për disa javë në një birucë në burgun e Ballshit vetëm pse tha “Atë krim do ta dënojë koha”.

Në ceremoninë e inaugurimit të Rrugës “Isa Boletini” në Staten Island, i pranishëm ishte edhe patrioti dhe aktivisti i njohur Esad Rizai, i cili në nëntorin e vitit 2018 me rastin e Ditës së Pavarësisë së Shqipërisë, me iniciativën e tij dhe mbështetjen e Presidentit të Bashkisë në Bronx Ruben Diaz, Jr., i akordoi Proklamatën e Nderit Heroit tonë kombëtar Isa Boletini. Ky tubim u ndoq gjithashtu nga afër nga deputeti i PD-së, Belind Këllici, ambasadorët shqiptarë Suela Janina dhe Blerim Reka; ish diplomati Mal Berisha, gazetari ish i persekutuar politik nga regjimi komunist në Shqipëri Beqir Sina, gazetari Halil Mula etj...


Isa Boletini i është akorduar titulli i lartë “Heroi i Popullit” nga shteti shqiptar, ndërsa në vitin 2010, Kosova i dha Çmimin “Urdhëri Hero i Kosovës”.

I paharruar qoftë jeta, vepra dhe kujtimi i Tij!

**II.**

**NIPI I ISA BOLETINIT PË RBALLË NIPIT TË GJENERAL VUKOVIQIT, VRASË SIT TË HEROIT NË BURGUN BALLSHIT**

Historia e Enver Dajçit në qelitë e diktaturës.... Enver Dajçi vinte nga një derë e njohur atdhetare, ishte nip i Isa Boletinit. Ai u bë një figurë e njohur gjatë Luftës së Dytë Botërore, por pas ardhjes së



Svetko, kështu quhej nipi i Vukoviqit, ishte ankuar në drejtorinë e atij burgu, që të largonin nga ai burg Enver Dajçin, me pretekstin se jeta e tij nuk ishte e sigurt aty nga nipi i Isa Boletinit, Enver Dajçi, i cili mund të hakmerrej ndaj atij. Kur babai im dëgjoi këto fjalë - shkruan Mimoza - si një personalitet me integritet të lartë intelektual dhe me gjakftohtësi të plotë përgjigjet: “Svetko për mua, të qëndrojë i qetë, pasi unë nuk jam hakmarrës. Kur xhaxhai i tij Vukoviq vrau Isa Boletinin, Svetko nuk kishte lindur ende, dhe nuk ka asnjë faj për atë krim, që do ta dënojë koha”. Dhe vërtetë ashtu ndodhi, Svetko doli gjallë nga ai burg, pa asnjë kërcënim për jetën nga im atë, ndërsa babain tim e izoluan për disa javë në një birucë në burgun e Ballshit vetëm pse tha “Atë krim do ta dënojë koha”. Enver Dajçi jetonte pranë vajzës së tij Mimoza dhe mbesës Merlin në Bronx, NY derisa ndërroi jetë në vitin 2015.

**PERSEKUTIMI I BOLETINËVE**

Hakmarrja e sllavo-komunistëve ndaj familjes së njohur të Isa Boletinit, filloi që në nëntorin e vitit 1943, kur komunistët shkodranë të udhëhequr nga Vasil Shanto vranë me atentat babanë tim nënkolonel Adem Boletinin, djalin e tretë të Isës i cili kishte mbaruar Akademinë Ushtarake në Vjenë (sidhe djalin e Ademit, Isain). Pas kësaj si në Mitrovicë ku jetonte pjesa më e madhe e Boletinëve, ashtu edhe në Shqipëri, familja jonë u gjend nën një persekucion të egër dhe barbar nga regjimet komuniste të Titos dhe të Enver Hoxhës. Nga ky represion i paparë që u ndoq ndaj djemve, nipave dhe mbesave të Isa Boletinit, numri i të vrrarëve dhe të ekzekutuarve nga familja jonë arriti në 15 vetë dhe dhjetë të tjerë vuajtën për vite të tëra në burgjet e tmerrshme të Serbisë dhe Shqipërisë.

Regjimi komunist i Enver Hoxhës ndaj familjes së Boletinëve ndoqi po atë politikë të cilën kishte nd-

janar 1916, së bashku me bijtë e tij Halilin dhe Zahidin, dy nipërit dhe tre luftëtarë të tjerë. Isa Boletini, vitet e rinisë i kaloi në vendlindje. Në prill të vitit 1881, si 17-vjeçar, ai mori pjesë në betejën e Shlivovës, ku u ndeshën trupat e Lidhjes Shqiptare të Prizrenit me ushtrinë osmane. Edhe pse në vitin 1908 ishte në krahun e xhonturqve, kjo lidhje u prish shumë shpejt. Në nëntor të vitit 1908, Porta e Lartë dërgoi një ushtri prej 7 mijë ushtarësh për të nënshtruar Kosovën.

Komandën antiosmane e kishte në dorë Isa Boletini. Gjatë tërheqjes, osmanët i dogjën kullën në shenjë hakmarrjeje. Më pastaj, Isa Boletini udhëhoqi kryengritjet e kosovarëve në Prishtinë, Prizren e gjetiu. Ai ishte një ndër udhëheqësit kryesorë të kryengritjes së pranverës së vitit 1910. Isa Boletini ishte bërë i njohur edhe për atë që i kishte ndodhur në Londër, kur edhe pas kontrollit që i kishin bërë rojat kur hyri për të takuar ministrin e jashtëm, Eduard Grej, ai ia kishte dalë që njërin revolver ta fuste brenda. Greji kishte bërë shaka me Boletinin duke i thënë se “atë që se bëri ushtria osmane, e bëra unë”. Me etjen për hakmarrje, serbët dhe malazezët u bënë bashkë me rusët dhe francezët për ta eliminuar Isa Boletinin. Atë që nuk e kishin arritur ta bënin në luftë balllore në fushëbeteja, ata e bëjnë në urën e shtetit fqinj, Malin e Zi. Konsulli francez në Podgoricë, Bichoc, është njeriu që nisi aplikimin e kurthit duke e ftuar Isa Boletinin të shkojë në Cetinjë, në mënyrë që prej andej ta dërgonte jashtë Malit të Zi. Boletini i besoi kësaj ndihme pa e menduar se në fakt po shkonte drejt ekzekutimit. Teksa ndodhej në Podgoricë ai u gjend në një kurth që i solli vdekjen. Në fakt, ajo nuk ishte thjesht një vrasje, por një kasaphanë. U vra gjatë një shkëmbimi zjarri me malazezët në Podgoricë së bashku me 17 shoqëruet e vet. Me 19 janar 1916 në Podgoricë, të Ura e Ribnicës, i zënë me pabesi nga malazezët, vritet Isa Boletini. “Pobjeda” e përditshme nga Titograd, më 26 maj 1980 e botoi kronikën e atëhershme ku thuhet se ngjarja kishte ndodhur më 19 janar. Isa Boletini u varros dy dytë pas vrasjes në Podgoricë, në një ceremoni ku morën pjesë një numër i madh njerëzish. Në vitin 1973, u bë kërkesa e parë për kthimin e eshtrave në vendlindje. Falë përpjekjeve të familjarëve dhe studiueseve varri u zbulua dhe më 15 nëntor të vitit 1979 u krye zhvarrimi. Në fakt këtë proces e shpejtoi dhe një projekti bashkisë së Podgoricës që në tokën ku preheshin eshtrat do të ndërtohej një park. Bashkë me eshtrat e Isa Boletinit u nxorën edhe eshtrat e të shtatë të vrrarëve të tjerë të masakrës së 23 janarit 1916. Ishin dy fakte që vërtetonin se ato eshtra i përkisnin Isa Boletinit: Epitafi mbi gurin e varrit, por edhe mungesa te eshtrat e gishtit të mesit në dorën e majtë. Sipas familjes Boletini, Isa e kishte prerë këtë gisht në moshën 3-vjeçare me sëpatë. Eshtrat u vendosën me kujdes në një arkë dhe u varrosën në një kënd të oborrit në xhaminë e Mitrovicës në fshehtësi të plotë.

Muhamet Shukriu, Latif Berisha, Asllan Murati ishin tre personat që u betuan me njëri-tjetrin që nuk do t’ia tregonin askujt këtë sekret. Një sekret që u mbajt deri në lirinë e Kosovës e më pas për të ndërtuar një memorial të veçantë. Ndërkohë, pas 100 vjetorit të pavarësisë së Shqipërisë, nisi procesi i verifikimit të eshtrave për të kryer një ceremoni zyrtare varrimi. Në korrik të vitit 2011, mbetjet mortore të Isa Boletinit dhe të bashkëluftëtarëve të tij, iu dorëzuan Komunës së Mitrovicës. Ato ia dorëzoi imami i kësaj komune, Mulla Asllan Murati, i cili 13 vjet pas rivarrimit nga Podgorica i ruajti në një vend të fshehur. Instituti i Mjekësisë Ligjore në Universitetin e Strasburgut, në janar të vitit 2014, konfirmoi se eshtrat e dërguara për ekzaminim ishin të Isa Boletinit. Më 10 qershor 2015, Isa Boletini u varros në oborrit e kullës së tij në Buletin të Mitrovicës.



Enver Hoxhës në pushtet, përfundoi në qelitë e errëta të hetuesisë komuniste. Ai nuk mund të pajtohej me shitjen e Kosovës të Jugosllavia, as me kthimin e Shqipërisë në një shtet-burg dhe shprehu pakënaqësitë hapur. Rreth tri vite i kaloi në tortura të skajshme në qelitë e ftohta të Hetuesisë së Enver Hoxhës që ia kalonte dhe atyre të Hitlerit. Pas gjyqit të inskenuar atë do ta dërgonin në Ballsh në kampin-burg, ku do të kryente dënimin pa bërë faje, madje edhe do ta ridënonin. Mimoza Dajçi aktiviste e njohur e komunitetit shqiptar në SHBA, presidente e Organizatës së Gruas Shqiptaro-Amerikane “The E omen’s Organization” “Hope & Peace” shprehet se: “Kur im atë kryente një pjesë të dënimit të tij si i ish-i burgosur politik në burgun e Ballshit në Shqipëri, atë kohë në atë burg vuante dënimin si i burgosur politik edhe nipi i gjeneralit Vukoviq, që kishte vrrarë Isa Boletinin.

jekur për shumë vjet regjimi komunist i Titos dhe si rezultat i kësaj vetëm në vitin 1962-in, Isa Boletini iu akordua titulli i lartë i Heroit të Popullit. Edhe pas kësaj familja e tij pati vetëm një ftesë zyrtare për të shkuar në Vlorë në përvjetorët e ditës së ngritjes së Flamurit dhe në 1981 kur u inaugurua monumenti i Isa Boletinit në Shkodër. Vepra e Isa Boletinit është nderuar në çdo kohë në gjithë Shqipërinë etnike. Emrin e tij e mbajnë shkolla, rrugë, lagje e sheshe. Gjithashtu ka një batalion special të ushtrisë shqiptare, që u instalua në Irak, që mban emrin e Isa Boletinit.

**DITA E VRASJES**

I lindur më 15 janar 1864 në kullën e Boletinëve, afër Mitrovicës, patrioti shqiptar Isa Boletini, ishte vrrarë pabesisht nga malazezët në Podgoricë më 23

## OPINION

*Historinë nuk e shkruajnë politikanët, por studiuesit dhe historianët profesionistë të papolitizuar dhe atdhetarë*

# Historia është shkruar me gjak, atë nuk mund ta shtrembërojnë pseudohistorianët



Nga Sakip CAMI

**M**bas viteve 90 pati një sulm neveritës deri edhe duke u vënë kazmën lapidarëve dhe memorialëve të LANÇ dhe të luftërave për liri dhe pavarësi të popullit shqiptar. Sulmi fizik u shoqërua me një fushatë histerike mediatike kundër të kaluarës së shqiptarëve, veçanërisht ndaj luftës antifashiste e antinaziste. Shqipëria u rendit në krahun e fitimtarëve të Luftës së dytë botërore, përkrah anglo-amerikanëve dhe Bashkimit Sovjetik dhe kjo renditje jo vetëm nuk vlerësohet nga disa politikanë e historianë servilë të politikës, por përkundrazi errësohet kjo periudhë.

Disa i mëshojnë fort tezës së luftës civile, a thua se nuk kishte forca pushtuese në Shqipëri gjatë Luftës së II Botërore dhe Shqiptarët nuk luftonin kundër pushtuesit por luftonin kundër njëri tjetrit për pushtet. Lufta civile është nocion i vjetër sa vetë jeta. Çdo pushtues e përdor atë për ta patur më të lehtë pushtimin dhe sundimin. Por të renditës në formacion me fashistët dhe nazistët kundër atyre që luftojnë për çlirim kombëtar do të thotë të jesh në vendin dhe kohën e gabuar.

Qenia në koalicionin antifashist e antinazist e Bashkimit Sovjetik përkrah ShBA dhe Anglisë nuk duhet të konfondohej me luftë politike, sepse kështu e menduan dhe vendosën angloamerikanët. Lufta ndaj Bolshevizmit u përdor nga e djathta shqiptare, Balli Kombëtar dhe Legaliteti si arsye për të mos bashkëpunuar me Frontin Nacional Çlirimtar (që drejtohej në ilegalitet nga Partia Komuniste Shqiptare) dhe për tu përplasur me njëri tjetrin. Sulmet ndaj LANÇ vazhduan dhe vazhdojnë ndaj dëshmorëve të rënë, pa menduar se sulmojnë shqiptarët që dhanë jetën për lirinë që gëzojmë sot. LANÇ nuk duhet të konfondohej me të pastajmen që ndodhi pas marrjes së pushtetit nga komunistët. Këtu është vija e kuqe ndarëse.

Nuk ishte në dëshirën e shqiptarëve të zgjidhnin me kë të qëndronin, me Lindjen apo me Perëndimin. Atë e vendosën fuqitë fituese të luftës sipas dëshirës së tyre. Goditja e historisë është strategji dhe luftë sistematike e armiqve të shqiptarëve. Ne jemi populli më i lashtë në Europë, me kulturë dhe trashëgimi të trashëguar deri në ditët e sotme, por objekteve historike e kulturore po u vihet kazma nga bosët e ndërtimit për fitime personale me leje ose me indiferentizmin e institucioneve shtetërore. Shumë studiues dhe historianë kanë brakti-

**• Në kuadrin e shkrimit të historisë nga Instituti i Historis dhe Akademi e Shkencave tu kushtohet vendi i duhur disa betejave legjendare të shqiptarëve sikurse është ajo e luftës kundër Hajredin Pashës në tetor 1844 dhe të vendoset pika mbi i për debate të tilla se kur u çlirua Shqipëria, apo nëse shqiptarët gjatë Luftës së II Botërore bënë luftë me njëri tjetrin apo me pushtuesit nazifashistë, ndërkohë që bota na ka renditur në krahun e fitimtarëve.**



**• Ne jemi populli më i lashtë në Europë, me kulturë dhe trashëgimi të trashëguar deri në ditët e sotme, por objekteve historike e kulturore po u vihet kazma nga bosët e ndërtimit për fitime personale me leje ose me indiferentizmin e institucioneve shtetërore.**

sur faktet, datat, vendet, pjesëmarrësit e ngjarjeve historike. Historia ka saktësinë e saj. Betejat dhe ngjarjet kanë ditëndodhjen, vendndodhjen, pjesëmarrësit, të rënë dëshmorë. Disa shkruajnë pa përgjegjësi, pa referenca, përdorin togfjalëshin "e të tjerë", në fillim të muajit, në fillim të vitit, qindra dëshmorë etj. Nuk mund të përmendësh dy apo tre dëshmorë dhe për të tjerët të shkruash e të tjerë sepse gjaku i derdhur është gjak shqiptari, janë bij nënash të gjithë. Nuk mund të shkruash vetëm emrin e komandantit të njësisë dhe të shkruash e të tjerë sepse luftën nuk e bën një komandant i vetëm sado i zoti të jetë, por bashkë me ushtarët.

Do të thotë ndonjëri se ushtarë e komandantë të "vegjël" ka shumë dhe nuk përmenden të gjithë, por kurrësi të shkruash për Shtabin e Përgjithshëm të LANÇ dhe të mos i përmendësh të 12 anëtarët e tij. Thuhet se në Kongresin e Manastirit morën pjesë 50 delegatë, nga këto 32 me të drejtë vote. 18 delegatëve të tjerë nuk u shkruhet emri a thua se Bajo Topulli është më pak i rëndësishëm se 32 delegatët votues. Shkruhen vetëm 40 firmëtarët e pavarësisë dhe "harrohen" 43 delegatët e tjerë. Mbledhja zgjati 4 ditë dhe ata që arritën me

vonesë në Vlorë përmes plumbave e acarit nuk shikohet e arsyeshme të shkruhen nga "historiani". Rrjetet sociale po luajnë rol pozitiv dhe negativ në fushën e historisë. Përveç faktit që janë bërë të gjithë historianë mburren e krahasohen midis krahinave, nxisin përçarje e ndasi. E mira qëndron në faktin se janë zbuluar nga pluhuri i harresës njerëz dhe ngjarje që historia e periudhës komuniste i kishte mbuluar.

Kombi ynë, ndonëse relativisht i vogël ka histori të lavdishme.

Por kombet pa histori pushojnë së ekzistuari, prandaj të punojmë fort dhe me vërtetësi për historinë tonë. Ku janë shtatorët e mbretërve ilirë? Ku janë vendosur për tu vizituar nga të vegjlit dhe të rinjtë, nga të gjithë? A ndodh kjo në shtetet e tjera fqinje dhe europiane? Sigurisht që jo. Kohët e fundit është vënë re një dukuri e rivendosjes së memorialëve, por me mangësi të theksuara. Në këto memorialë nuk shkruhet data, emri i pushtuesit, emri i dëshmorëve etj., sikurse ndodhi në memorialin e Gjoricës ku në vend që të thuhet se këtu në Gjoricë të Dibrës në tetor 1844 malësorët dibranë u ndeshën dhe përzunë me turp forcat osmane të komanduara nga Hajredin Pasha, vendoset formula e betimit të Nandë Maleve të Dibrës në luftë kundër pushtuesit, bile harrohet edhe të shkruhet edhe një mal historik kur dihet se në aspektin historik, Dibra është unitet i nandë maleve dhe krahinave të Topalltisë (Fushës dhe qytetit të Dibrës së Madhe), krahinës së Gollobordës dhe Bajraqeve të Lurës. Kjo ndodh, mendoj unë, për qëllime politike të ditës, për qëllime elektorale dhe për bashkëpunime ndërkombëtare me interesa të paqarta.

Më duhet të sqaroj se me dashje apo për injorancën e tyre konfondohej Perandoria Osmane me Turqinë e sotme, fashizmi me Italinë e sotme, nazizmi me Gjermaninë e sotme dhe në vend të fqinjësisë së mirë, herë-herë ushqehet urrejtje, pa menduar se shqiptarët sot punojnë e jetojnë masivisht në këto vende. Historia nuk mësohet në shkolla megjithëse ekziston si lëndë.

Nuk ka si të shpjgohet ndryshe që pashai pushtues Hajredin Pasha njihet si hero nga shumë shqiptarë deri edhe politikanë ligjvënës. Politika ndërhyrë kaq shumë në histori sa që krijon ndasi dhe megjithëse është përcaktuar me ligj dita e çlirimit, të majtët e nderojnë me datën 29 nëntor dhe të djathtët më 28 nëntor.

Pas shkatërrimit të muzeve në vitin 1991, sot kemi shumë pak muzeume, kur do të ishte e nevojshme dhe e mundshme që të kishim në çdo bashki. Së fundi mendoj që në kuadrin e shkrimit të historisë nga Instituti i Historis dhe Akademi e Shkencave tu kushtohet vendi i duhur disa betejave legjendare të shqiptarëve sikurse është ajo e luftës kundër Hajredin Pashës në tetor 1844 dhe të vendoset pika mbi i për debate të tilla se kur u çlirua Shqipëria, apo nëse shqiptarët gjatë Luftës së II Botërore bënë luftë me njëri tjetrin apo me pushtuesit nazifashistë, ndërkohë që bota na ka renditur në krahun e fitimtarëve.

## 82 VJETORI

*Rruga heroike dhe e lavdishme e Brigadave të V-të dhe VI-të Sulmuese*

# Brigada e V- të, formacioni më i madh luftarak i UNÇSH në qarkun e Vlorës

**B**rigada e Pestë Sulmuese “Heroinë e Popullit” është formacioni më i madh luftarak i UNÇSH në qarkun e Vlorës, formuar mbi bazën e dy batalioneve partizane “Ismail Qemali” dhe “Halim Xhelo”, si dhe vullnetarëve të rinj që plotësonin radhët.

Brigada e Pestë është një nga 27 brigadat e Ushtrisë së lavdishme NÇL. Vlen të theksojmë se efektiviteti i saj përbëhej nga bijtë e bijat më të mira të Vlorës e të Labërisë, luftëtarë të vjetër, ish-partizanë të Çetës “Plakë” të Vlorës, e të shumë njësive të tjera.

Datëlindja e parë e kësaj njësie luftarake që përkon dhe me një ditë të shënuar 31 vjetori i Pavarësisë nga Ismail Qemali. Fillimisht kishte 3 batalione, me një efektiv të përgjithshëm prej 960 partizanësh. Me një organizim të tillë, Br.V S ishte formuar që më 28 nëntor 1943 në Gumenicë, madje ishte angazhuar në luftime për përballimin e operacionit nazist “Bergkessel” në luginën e Lumit të Vlorës, në dhjetor 1943.

Luftimet e para brigada e V-të e sapo formuar, jo e plotë i zhvilloi në Dukat dhe në qafën e Këçkut batalionin e tretë. Detyra ishte për të penguar çdo përpjekje të armikut për të depërtuar në zonën e Lirë të Mesaplikut dhe Kurveleshit.

Në këto kushte armiku filloi të tërhiqej nga Gjormi. Gjatë luftimeve në tërheqje, një mitroloz gjerman gjuante me breshëri në drejtim të pozicioneve të partizanëve dhe ra në krye të detyrës duke luftuar Komandanti Abaz Shehu së bashku me dy korrierat trima dhe besnik Bilal Malaj dhe Xhuvël Xhemali.

Në periudhën nga 28.11.1943 deri më 20 janar



1944 u arrit që të formohen edhe dy batalione me luftëtarë dhe kuadro. Megjithë vështirësitë e

dimërit, në saj të angazhimit të gjitha strukturave partiake dhe këshillave të fshatrave u arrit që forcat partizane që do merrnin pjesë në inagurimin e brigatës të grumbulloheshin në Bramyshnjë të Tërbaçit.

Ajo u përrua më 20 janar 1944 në fushën e Bramyshnjës së Tërbaçit dhe përbënte një ngjarje me rëndësi të madhe politike-ushtarake. Më 20 janar 1944, Brigada u plotësua me 5 batalione me mbi 1200 partizanë, fillimisht secili me nga 3 kompani.

Efektiviteti i përgjithshëm i Brigadës nga 1200 partizanë në Bramyshnjë, kur po nisej nga Novipazari më 15 mars 1945 numri efektiv i Brigadës arrin 3000 luftëtarë. Brigada kishte 5 batalione me nga 200- 400 partizanë dhe në çdo batalion kishte 4 kompani me nga 40-80 vetë. Karakterizohej nga thellësia e veprimeve luftarake në drejtim 2300 km, me temp minimal e maksimal të marshimeve: 20-50 km në ditë, si dhe vazhdueshmëri të marshimeve të sforcuara 3-5 ditë.

Rruga luftarake e Brigadës së Pestë, e betejave të saj të lavdishme, duket nga vetë luftimet e ashpra e të pandërprera që ajo zhvilloi prej skajeve jugperëndimore të Atdheut deri tek ato verilindore në Kukës e në Tropojë, në Gjakovë, në Prizren e në Drenicë të Kosovës, madje edhe përtej tyre, deri në Sanxhak e në Bosnjën Jugore. Luftimet e saj, si ato për thyerjen e operacioneve naziste në dimrin e viteve 1943-’44 në Zonën I Operative Vlorë-Gjirokastrë, ato të Sevasterit, të Kuçit e të Borshit në mars e në prill të vitit 1944, të Çarshovës e Biovizhdës së Përmetit në maj, të Qafës së Gjarpërit e të Gurit të Prerë gjatë thyerjes së Mësymjes armike të Qershorit 1944; kalimi i Shkumbinit dhe luftimet në Shupal të Tiranës, në Macukull e Klos të Matit, në Sinë e Korab të Dibrës, në Lumë të Kukësit, në Gjakovë e Prizren dhe në malet me borë të Sanxhakut, do të kujtohen gjithnjë si beteja, ku është derdhur shumë gjak trimash të kësaj njësie partizane kundër një armiku të madh, të egër, të fuqishëm dhe të armatosur gjer në dhembë.

## “Dil nëno dhe shiko jashtë, si lufton Brigada e gjashtë”



batalione partizane të këtij qarku, të cilët ishin sprovuar në fushën e luftës dhe kishin fituar një përvojë të madhe. Ajo përshkoi një rrugë të gjatë luftarake ku dhanë jetën 203 dëshmorë nga të cilët 10 heronj të popullit. Sakrificat e saj ishin të panumërta, kontributi i saj ishte i madh në çlirimin e disa qyteteve dhe krahinave të vendit. Në luftimet e zhvilluara spikati gjithmonë guximi dhe trimëria. Rruga luftarake e saj ishte e lavdishme dhe heroike.

Heroizmin e partizanëve të kësaj brigade popullore e përvetësoi në këto ditë:

**“Dil nëno dhe shiko jashtë,  
si lufton Brigada e gjashtë.  
Trimat tanë të Shqipërisë,  
sollën dritën e lirisë,  
në këtë tokë plumb të rëndë,  
me mençuri, pushkë dhe këngë...”**

Sot pas 82 vjetësh në përkujtim të kësaj dite historike me krenari shprehim respektin dhe mirënjohjen për të gjithë ata që u angazhuan në këtë luftë të rëndësishme për lirinë e vendit. Kjo ditë ishte zanafilla e realizimit të shumë ëndrrave për atdheun tonë me sakrificat e së djeshmes dhe punën e sotme për të ecur përpara në rrugën e progresit dhe zhvillimit duke u përpjekur për të bërë më të mirën për qytetin tonë dhe të ardhmen e tij europiane. Natyrisht duke vazhduar të kujtojmë me respekt të gjithë ata që e deshën atdheun aq shumë duke dhënë jetën për të.

**B**rigada e VI-të Sulmuese, për kontributin e saj të vyer në luftën për çlirimin e atdheut u quajt “Heroinë e Popullit”. Ajo u krijua në Përmet më 26 janar 1944 në kulmin e operacionit armik të dimrit.

Brigada e VI-të u themelua nga shkrija e çetave “Çerçiz Topulli”, “Hajredin Tremishti”, “Avni Rrustemi” dhe “Toto Bolena”. Me këto çeta u krijua batalioni i parë më 7 gusht 1943, që u quajt “Asim Zeneli”. Komandantët dhe komisarët e kësaj brigade qenë sipas radhës: Komandant Tahir Kadare; Komisar Mustafa Matohiti; Zv. Komandantw: Riza Veipi, Jaho Gjolicu, Haki Toska, Sotir Filto dhe Xhule Çiraku

Ishte e para brigadë partizane në Qarkun e Gjirokastrës dhe në përbërjen e saj u rreshtuan

## HOMAZH



## KOLONEL SHPËTIM KALO, KUADRI USHTARAK MODEL I USHTRISË SHQIPTARE

• *Kolonel Shpëtim Kalo i mbështeti proceset demokratike dhe reformat ne ushtri, por si masa më e madhe e ushtarakëve e përjetoi me shumë dhimbje shkatrrimin e ushtrisë në vitin 1997, të cilës ia kushtoi pjesën më të madhe të jetës në shërbim të mbrojtjes së Atdheut...*

Malin e Zi.

Në këtë detyrë Shpëtimi qëndroi për afro pesë vite, ku u dallua për organizim, planizim e kordinim të detyrave stervitore e luftarake në bashkëpunim me komandat e reparteve vartëse të BrK, duke e mbajtur Shtabin kompakt e të gatshëm në çdo kohë e për çdo situatë. Këtij qëllimi i kanë shërbyer stërvitjet treguese stërvitjet e kompaktesimit të reparteve si dhe stërvitjet me shtabin e brigadës e shtabet e reparteve të formes praktikë e stervitje shtabi, po kështu edhe stervitjet komando-shtabi dy shkallëshe brigade- batalion.

Më pas nga viti 1984 deri në vitin 1992 Shpe-

në terren për realizimin e detyrave në fushën e mbrojtjes ku ka gëzuar respekt të veçantë. Kështu për rezultatet e larta në kryerjen e detyrave është dekoruar me Urdhëra e Medalje si dhe është shpallur "Oficer Shëmbullor"

Kolonel Shpëtim Kalo i mbështeti proceset demokratike dhe reformat ne ushtri, por si masa më e madhe e ushtarakëve e përjetoi me shumë dhimbje shkatrrimin e ushtrisë në vitin 1997, të cilës ia kushtoi pjesën më të madhe të jetës në shërbim të mbrojtjes së Atdheut.

Kolonel Shpëtim Kalo pas daljes nga ushtria aktive, ne rezervë e pension, militoi në Shoqatën

### Kolonel Ali DEMUSHI\*

Më 22 nëntor 2025, familja, të afermit, shokët e kolegët, miqtë e dashamirët e shumë nga qyteti i Shkodrës i dhanë lamtumirën ish kuadrit të lartë të Ushtrisë Shqiptare, kolonel Shpëtim Kalo.

Shpëtimi lindi më 11 nëntor 1941 në Palorto të Gjirokastrës, në një familje me tradita të larta atdhetare e patriotike që kishte vënë pasurinë e saj në shërbim të çështjes kombëtare shqiptare.

Pasi mbaroi studimet në vënd lindje, deri në dy klasë të shkollës së mesme, me shkuarjen e familjes së tij me banim në Shkodër e përfundoi atë duke marrë maturen në gjimnazin " 8 Nëntori" me rezultate të mira në vitin 1959.

Pas përfundimit të shkollës së mesme, Shpëtimi vazhdoi studimet e larta në Shkollën e Bashkuar të Oficerëve në Tiranë në armën e këmbësorisë, të cilën e përfundoi në vitin 1962 me rezultate shumë të mira dhe u titullua me Urdhër të Ministrit të Mbrojtjes, Oficer me gradën Nëntoger.

Shpëtim Kalo që nga viti 1962 e deri sa doli nga ushtria aktive nga reforma e vitit 1992, për 30 vite rresht i shërbeu atdheut me devotshmëri e përkushtim maksimal në repartet dhe njësitë ushtarake të ish Korpusit Ushtarak në Shkoder, ( RU 8001), që nga Bushati, Kukësi, Tropoja, Kopluku e në Vaun e Dejës, duke kryer detyra nga niveli bazë, komandant toge, kompanie e batalioni këmbësorie dhe batalioni art- mitralier, ku këtë të fundit e komandoi dhe drejtoi për rreth katër vite në Qafë Prush të Hasit, përballë vijës kufitare me ish Jugosllavinë.

Me përkushtim maksimal e sakrificë të mbëdhë në kushtet e vështira të dislokimit e të jetesës si repart i vijës së parë të brezit të mbrojtjes së Brigadës së Këmbësorisë të Tropojës (RU 9200), Komandanti Shpëtim Kalo mundi të siguronte kushte jetese normale për efektivin ushtarë aktiv, stërvitjen e gatishmërinë e tij me nivel e cilësi të lartë sipas kërkesave të kohës, duke e bërë Repart Shëmbullor, nga i cili kishin çfarë të mësonin repartet e tjera të brigadës..

Por me përfundimin e studimeve në Akademinë e Mbrojtjes (e Shtabit të Përgjithshëm të Ushtrisë), në fillim të viteve 70- të të shekullit të kaluar, Shpëtim Kalo u kompletua me njohuri e dije më të plota shkencore mbi Artin Ushtarak dhe mbrojtjen në tërësi të nivelit Operativo-Strategjik. Mbi këtë bazë u emërua Shef Shtabi ne Brigaden e Këmbësorisë (BrK) në Kopluk të Malësisë së Madhe. Ishte ajo BrK e vijës së parë të brezit të mbrojtjes së Korpusit Ushtarak të Shkodrës, përball vijës së kufirit shtetror me



tim Kolo për 8 vite rresht, i emëruar me Urdhër të Ministrit të Mbrojtjes, kreu detyrën e Komandantit të Shkollës për përgatitjen e kuadrove rezervist për repartet e ushtrisë, në Vaun e Dejes të rrethit Shkodër. Në atë detyrë shumë të rëndësishme Shpëtimi e ndërtoi punën në mënyrën më të mirë me trupën mësimore e stërvitore, officer, pedagog dhe komandues për nivelin e mësimdhënies dhe të stërvitjes në disiplinat e ndryshme për përgatitjen dhe aftësimin e kuadrove rezervë të perspektives për repartet e ushtrisë. Aty krahas mësimave për njohjen e rregulloreve bazë e atyre të armatimit e perdorimit të armeve, organizoi e zhvilloi mesime metodike, instruktivometodike si dhe stervitje treguese shëmbullore te cilat benë të mundur nxjerrjen e shumë kuadrove rezervë të nivelit të knaqëshëm.

Me rivendosjen e gradave ne ushtri në vitin 1991 Shpëtim Kalo u gradua Kolonel. Ai ishte kuader ushtarak i vlerave më të mira morale, njerezore e qytetarie, me personalitet e dinjitet të lartë, i aftë profesionalisht, i dashur dhe i respektuar me shokët, kuadrot, eprorët dhe efektivat por edhe i dalluar për komunikim e bashkëpunim me organet e pushtetit e te ekonomise

Aleanca Kombetare e Ushtarakëve të Shqiperisë, dega Shkodër.

Kolonel Shpëtimi njëherësh ishte edhe familjar shëmbullor. Ai me basheshorten Shyqyrije, (tashmë e ndjerë), lindën, rritën, shkolluan dhe edukuan tre fëmijë të cilët sot janë shëmbull pozitiv në shoqërinë tonë, prej të cileve djali i tyre Akili sot është kuadër i lartë në Policinë e Shtetit si dhe dy vajzat Suzana dhe Anila te cilat tashmë kanë krijuar familjet e tyre të nderuara e te respektuara.

Në ceremoninë mortore për Kolonel Shpëtim Kalo, moren pjesë shumë ish kuadro të ushtrisë si dhe nga komuniteti shkodran, ku për jeten dhe veprimtarinë e Tij, në emër të Shoqatës Aleanca Kombetare e Ushtarakëve dhe të OBVL-së dega Shkoder foli Kolonel Vuksan Vukaj (P) duke e ngushlluar familjen e të ndjerit Shpëtim e duke i premtuar se Ai do të kujtohet e do te rrojë ne kujtesen e shoqerisë ushtarake, si modeli më i mirë i kuadrove te Forcave të Armatosura të Shqiperisë.

I perjetshem kujtimi i Tij!

\*Kryetar i OBVL- se dega Shkoder.

## SIMPOZIUMI

Dy veprimtari përkujtimore të rëndësishme historike

# PUKË, SIMPOZIUM NË PËRKUJTIM TË DËSHMORIT ALI BYTYÇI

• *Ali Bytyçi qe i pari dhe i fundit komisar olitik, Sekretar i Parë i PK të Pukës që arriti t'i trajtonte problemet politike e nevojat qytetare gjithnjë sipas parimeve demokratike të Konferencës së Pezës (pa dallim krahine, feje e ideje)*

## Xhemal Meçi, Mjeshtër i Madh

Dy veprimtari të realizuara me madhësinë që meritojnë, përkujtimi i 80-vjetori të Çlirimit të qendrës së Nënprefekturës së Pukës të Qytetit Pukë dhe simpoziumi kushtuar patriotit Ali Bytyçi do të mbeten gjatë në memrien e pjesëmarrësve dhe organizatorëve, si dhe do të zënë vend nderi në analet e histories së këtij rrethi.

### PAK NGA HISTORIA

Gjatë muajit Nëntor 1944 hynë në fshatrat e krahinës së Pukës dy brigada partizane, Brigada VI-t dhe brigada e 22-t S. Brigada e IV që kishte marrë pjesë krah brigadave të tjera partizane në Çlirimin e Shpallit të Mirditës, në vazhdim do hynte në fshatrat e Pukës, duke kaluar për fund Malit të Tërbunit e në Qërret, ku u prit me entuziazëm. Po kështu në Dedaj, Qelëz, Midhë, Iballe deri në Dardhë të Pukës.

Gjithashtu Brigada 22-S ndoqi fshatrat bregut të Fanit të Madh që nga Gjegjani, Gojani Shkoza, Qafa-Malit, Kryezi dhe Iballe, kudo duke ngritur Këshillat N.Ç.L dhe Komunitat vendore të Pushtetit të ri N.Ç.L


### KUSH ISHTE ALI BYTYÇI

Ali Bytyçi me braktisjen e studimeve në Italinë fashiste dhe kthimin në Atdhe, në vendlindjen e tij në Qërret korrik 1943, i vuri detyrë vetës me qellimin për nxitjen dhe organizimin e Luftës Nacional Çlirimtare antifashiste në Nënprefekturën e Pukës e më gjërë. Së pari filloi me ndërgjegjësimin e të rinjve aktiv për ta ndihmuar në qelimin e Tij. Kështu me përpjekje të përditshme me këto individ arriti t'i bëjë që të jenë të gatshëm për përkrahjen e Aliut në realizimin e qellimit të Tij për nxitjen dhe organizimin e LNÇL në Qërret e më gjërë.

Fillimisht arriti të afrojë rreth vetës shokët si Nezir Ismail Djaloshi, Selim Zog Zyber Djaloshi, Islam Çoba bashkë me Ymer Çobën e Zenel Kadri Çoba, si dhe Idriz Metin. Po edhe të moshuar si Boç Zeqiri me të birin Nezirin etj, deri me Kadire Pema, Pashk Currin e Nikoll Qafen të Fushë-Arësit, me ndihmen e këtyre, arriti të afroji dhe të ndërgjegjësoi edhe të rinjtë vellezërit Islam e Sadik Bajram Mehmet Pema. Po kështu filloi kontaktet me Zenel Islam Shkrelin bashkë me Ismajl Avdi Shkrelin dhe Nuh Hasanin e Dedajve, si Nanë Shoten dhe Elez Hoxhen e Pukës, siç kishin afruar edhe hoxhën e Qërretit, Qazim Nushi ish emigrant politik, Gjakovar.

Ky grup aktivistësh në takimet gjoja të rastësishme e dëgjonin me vëmendje fjalën e Aliut se fashizmi Italian nuk i sjellë asgjë të mirë popullit tonë, veç robëri dhe shfrytëzim të pasurive tona kombëtare për interesat e veta prej pushtuesi.

Kështu Konferenca e Pezës shtroi para gjithë popullit shqiptar organizimin dhe fillimin e Luftës Nacional Çlirimtare deri fitoren e plotë mbi fashizmin dhe Nazizmin Gjerman e aleatin e Tij.



Kjo luftë që të bëhëj gjithë populllore duhet të zhvillohej mbi parimin Luftë Nacional Çlirimtare pa Dallim Krahine, Feje e Ideje.

### NDIKIMI I ALI BYTYÇIT PËR ORGANIZIMIN E LANÇ NË PUKË

Pra, sqaronte pa pushim i shquari Ali Bytyçi plot entuziazëm e frymzim, duke ngjallë besim e gatishmëri te shokët e Tij, të cilët filluan të afronin të rinjtë të vendosur e besnik si edhe Sadik Cina e Bajram Ymer Baci dhe Islam Kadria në Meçe, bashkë me Ymer Kadri Furrikun e Zeq Hysenin në Kabash dhe Elez Ukë Llukën në Llukë, Halil Çelë Tërbuni në Pezhve, Lazër Dedë Tusha në Dush, Mehmet Rama, Zef Miraka, Mal Jah Zeneli e Mal Bajram Sokoli në Iballe, Nikoll Memë Çuku, Dodë Marka Lleshi e Osman Sheqer Braha në Kryezi, Riza Mustafë Aga etj.

Me këtë shtrirje të ndikimit të Ali Bytyçit gati gjithë krahinore, i doli si detyrë të kalonte në shumë Katunde, si Dush, Dedaj, Qelëz, Kabash, Kryezi, Iballe etj., të kalonte dhe në Tropojë për lidhje bashkëpunim krahinor. Por do t'i duhej të kalonte maleve me udhëtime të vështira siç e zuri bora në fillim dimrin e viteve 1943-1944. Ishte kujdesi vëllazëror i Islam Çobës që ta sillte gjallë deri Ndërlymna të Iballës, ku e pritën miqësisht me shërbime të kujdesshmë ta sillnin në gjendje normale.

Kështu shëndeti i Aliut filloi të dobësohej sa ftohja i dha shenjat e para të tuberkulozit.

Afrimi i Brigadave Partizanr drejt Pukës nuk e gjeti të papërgatitur, përkundrazi. Me Nanë Shotën, kërkoi që i vëllai i saj Mehmet Rama, Mal Barami, Mal Jah Zeneli, si dhe Zef Miraka me vellezërit Stak e Jak Pemati dhe Mustaf Aga i Zotnive të Iballës ta pritnin Brigatën Partizane miqësisht. Kështu Mustaf Zenel Aga u priu afër 70 burrave e të rinjve Iballas dhe në Qarrami, sapo u afruan partizanët e Brigatës VI-S, u thirr që larg: "Mirësevini Partizanët e Ali Bytyçit". Komandanti i Brigadës Jaho Xhiliku, që e kishte në krah Aliun i tha "Urime Ali Bytyçi! Iballja jote po na pret krah hapët e miqësisht!"

Po kështu Aliu i kishte marrë masat që vellezërit Islam e Sadik Bajram Pema i kishte çue te miku i tyre



Qarret 1918-1945

Riza Mustaf Agë Kryeziu, se gruaja e tij ishte e motra e tyre. Kështu Riza Agë Kryeziu, u prini mëse 20 kryezezëve, bashkë me to edhe priftin e fshatit Dom Mazreku, që I pari kritikoi Kordiniano si Anti Shqiptar. Në Qafë-Arrë, kufi me Qafë -Mali, i priti Partizanët e Brigatës 22-S. me përhëndetjen miqësore: "Mirësevini Partizanët e Ali Bytyçit në Kryeziun tuaj!" Kjo pritje kaq bujare e gëzoi pa masë Komandantin e kësaj Brigate (22-S) Sali Verdha: -"Qofshi faqebardhë e Ali Bytyçin tuaj e paqi me shëndet!"

Kështu u pa puna patriotike e Ali Bytyçit në priten e vëllazërve të këtyre dy brigadave partizane, si edhe të tjerave në vazhdim.

Tani, si u zgjodh Komisar Politik në Mbledhjen e Këshillit Nacional Çlirimtar të Pukës, më 7 Nëntor 1944 në Iballe, i dilte detyra e përgatitjes së forcave Partizane vendase që në kuadrin e Brigatës 22-S të arrinte qelimin final, Çlirimin e Pukës, Kryeqendra e Nënprefekturës Pukë.

Dhe mbështetur në përvojën e fituar, duke u nisur nga lidhjet farefisnore e familjare, simbas traditave vendore dhe duke shfrytëzuar parimet e Konferencës së Pezës: L.N.Ç.L pa dallim Krahine, Feje e Ideje, arriti të mobilizonte shumë Partizanë nga Qërreti, Kçira, Dushi e Komani si edhe nacionaliste antinazifashist, iu bashkuan Brigatës 22-S dhe në mbrëmjen e 19 Nëntorit sulmuan qytetin e Pukës, ku ishin grumbulluar forcat e fundit nazifashiste, të cilat u shpartalluan pas pak orësh të furishëm të partizanëve trima dhe kështu Puka në 20 Nëntor 1944, që në mëngjes, ishte e çliruar. Qindra qytetarë e partizanë brohoritnin sheshit dhe Uronin të gëzuar Ali Bytyçin komisarin e Pukës dhe imam Elez Hoxhën, Kryetarin e Komitetit Ekzekutiv të Rrethit.

Ali Bytyçi qe i pari dhe i fundit Komisar Politik, Sekretar i Parë i P.K të Pukës që arriti t'i trajtonte problemet politike e nevojat qytetare gjithnjë simbas parimeve demokratike të Konferencës së Pezës (Pa dallim Krahine, Feje e Ideje). Po fatkeqësisht tuberkulozi po ja paksonte fuqite. Edhe pas mjekimit në Itali, prap kaloi në Jetën e Përtejme, duke lënë mjerim jo vetëm në Familjen Bytyçi e Qërretin e Tij të dashur, si edhe tërë Pukën, që kudo e priti plot shpresë,

Varrimi i Tij u bë me një ceromoni madhështore të këtij të riu 27 vjeçar që gjithë rininë e Tij e shkriu për Çlirimin e Vendlindjes si dhe tërë Atrdheun.

Prandaj në Simpoziium modest u e zhvillua, pikërisht, në 80-vjetorin e Çlirimit të Pukës, përpjekum këtë personalitet të shquar atdhetar, Dëshmor i Atdheut, për meritat dhe pavdekësinë e të cilit do të shkruajmë në vëllimin e II të librit kushtuar Dëshmorëve të Atdheut të Pukës, që do të botohet para 5 Majit 2026. Për këtë Simpoziium familja Bytyçi luajti një rol të rëndësishëm në plotësimin e të gjitha kërkesave për zhvillimin e një përkujtimoreje sa më të denjëte për Dëshmorin Ali Bytyçi, sa dhe Dr.Gjergji Velo Kryetar i OKOASH i vlerësoi shumë këto veprimtari.

## REFLEKSIONE

*Fatkeqësi e kombit tonë dhe e Shqipërisë së gjorë, që ka rënë në duart e një njeriu të përbindshëm*

# MUSINE KOKALARI MODELI I FJALËS SË LIRË TË INTELEKTUALIT

- *Mëkati i saj ishte se nuk kishte asnjë mëkat, dhe kërkonte edhe për të tjerët një jetë më të mirë, ku njeriu të ndihej njeri, ku gjithkush ta kuptonte se kjo liri duhej kërkuar së pari brenda vetes...*



## SHPENDI TOPOLLAJ

**N**dofta, te mënyra se si u soll me Musine Kokalari, duket më mirë se kudo tjetër, pashpirtësia kriminale e Enver Hoxhës. Pasi i pushkatoi pa as më të voglin faj, dy vëllezërit e saj, Mumtazin dhe Vesimin, në bodrumet e hotel "Bristolit", krahas Kokalareve të tjerë, i vunë prangat edhe Musinesë, e cila e kaloi jetën burgjeve dhe internimeve, ashtu e torturuar dhe e poshtëruar, dhe sikurse besohet, jo vetëm nga dëshira e bashkës së Gjykostrës për të zhdukur intelektualët apo ata që kishin kujtime jo aq të mira për të, por edhe pse iu refuzua kërkesa e tij për t'u martuar me Musinenë.

Kjo del fare qartë te letra që tre ditë para vrasjes, i dërgon Mumtazi zonjës Makhule Xomo Vrioni, ku thotë: "Ai ka urdhëruar djajtë e kuq kundër nesh. Kjo kuptohet: Thjesht për motive personale, se ne kemi qenë kundërshtarë të okupatorit Nazi-Fashist dhe kemi punuar thjeshtë për të mirën e përparimin e Kombit. Siç e kemi biseduar edhe herë të tjera, fatkeqësi e kombit tonë dhe e Shqipërisë së gjorë, që ka rënë në duart e një njeriu të përbindshëm, tinëzar, hakmarrës, inatçi, dinak, megalloman, egoist, që i do njerëzit nën vete, kumarxhi, gënjeshtar edhe kur qe jashtë për studime nuk dha asnjë provim, mbeti pas kabareve, kazinove etj. Ne intelektualët gjykostritë ia dimë të gjitha dhe sa i vlen lëkuara prandaj kërkon të na asgjësojë".

Dhe pikërisht ky pasazh të ndjek pas në çdo faqe të librit "Musine Kokalari një Yllësi", përgatitur me shumë korrektësi nga ana e historianit të mirënjohur Uran Butka. Ecin këtu paralel dy jetë: ajo e Musinesë, intelektuale, atdhetare dhe luftëtare e paepur e fjalës së lirë, dhe ashtu pa u dukur, por që e ndjek si hije e zezë, ajo e diktatorit, që tërë veset e tij të këqia si; hipokrizia, narcisizmi, mosmirënjohja, shkelja e çdo norme njerëzore, pabesia, mbytja e mendimit të lirë, mungesa e mëshirës, falsifikimi i



historisë...i vë në shërbim të mbajtjes së pushtetit. Dhe këtu nuk ka ndonjë gjë të panjohur; pasi kohë më parë George Orwell e kishte thënë se "Pushteti është një qëllim, jo një mjet. Nuk vendoset një diktaturë për të mbrojtur një revolucion, por bëhet një revolucion për të vendosur një diktaturë".

Për hir të së vërtetës, duhet pranuar se Enver Hoxha nuk e pati të vështirë të sundojë si një diktator i paskrupullt, pasi në Shqipërinë e pas çlirimit, ishin ato kushtet që përmend Sandro Pertini që për ta ngritur e mbajtur në këmbë atë, nuk mungonin të uriturit dhe të papunët, si materiali nga i cili diktatura ndërtohet.

Të tillët, pra turma e hallexhinjve i urrenin për vdekje të pasurit, nga që vetë ishin troku, i donin të poshtëruar të diturit, ngaqë vetë ishin analfabetë, brohorisnin të fortin, ngaqë vetë ishin të dobët, shpresonin te dogmat e komunizmit, ngaqë nuk e njihnin fare atë, prandaj dhe thërrisnin pa e vrarë mendjen shumë: "kriminelët në litar!", prandaj edhe atje në internim i kishin mësuar edhe fëmijët e tyre ta quanin Musinenë "armike", dhe jo vetëm që i largoheshin asaj, por edhe kur ndërroi jetë ajo grua dinjitoze, nuk i shkoi askush në varrim.

Por cili qe "mëkati" i kësaj gruaje të ditur e guximtare? Mëkati i saj ishte se nuk kishte asnjë mëkat, dhe kërkonte edhe për të tjerët një jetë më të mirë, ku njeriu të ndihej njeri, ku gjithkush ta kuptonte se kjo liri duhej kërkuar së pari brenda vetes. Pastaj, cila qe origjina e saj, familja ku u rrit dhe u edukua, shkollimi që kreu, vepra që shkroi dhe lëvizja politike që ndërmoi? Ja si shkruan për këtë vetë ajo, atje në vetminë e asaj dhomës së varfër në Rrëshen: "Në familjen tonë sundonte fryma e re, e diturisë, e punës. Në shtëpinë tonë kishte hyrë dituria edhe në qëndrimet familjare. Mënyra të prera, fjalë të pakta, pavarësia e secilit, pa ngatërruar njëri - tjetrin. Librat ishin kudo. Dhe arsimimi, mbi të gjitha... Ky ishte ambjenti familjar, ku u rrita unë". Dhe në këtë ambjent familjar të rrethuar nga librat, zotëronte mendimi i filozofit helen Sokratit se "...ata që janë shkolluar, jo vetëm janë të lumtur dhe e menaxhojnë mirë shtëpinë e tyre, por u bëjnë dobi edhe njerëzve të tjerë". Prandaj, edhe Reshati, babai i saj që kishte studiuar për jurisprudencë dhe kishte shërbyer si kryetar gjykate në Turqi, e më pas, për 25 vjet si avokat, u kujdes që fëmijët e tij të arsimoheshin

sa më mirë.

## VËLLEZËRIT KOKALARI, NJOHËS TË DISA GJUHËVE TË HUAJA

Dhe ata, vëllezërit Kokalari, njohës të disa gjuhëve të huaja, me veprimtarinë e tyre kulturore dhe tepër atdhetare, deri dhe me botime nga letërsia jonë dhe ajo e huaja, u njohën si pjesë e rëndësishme e elitës kulturore shqiptare.

Ata çelën librarinë "Venus" dhe shtëpinë botuese "Mesagjeritë shqiptare", dhe mbanin lidhje me shqiptarin e madh dhe intelektualin e shquar Mit'had Frashëri dhe librarianë e tij "Lumo Skëndo". Dhe kulmi është se vëllai i vogël Hamiti, fituesi i çmimit "Prix d'excellence" për rezultate të shkëlqyera, dhe në vitin 1943 autor i librit "Kosova, djepi i shqiptarizmit" (e ribotuar e zgjeruar), në shqip e frëngjisht, ishte shok klase me Enverin, si në Gjykostrë, ashtu edhe në Liceun Francez të Korçës, dhe kishin si profesorë Mumtazin dhe Vesimin.

Shiheni ironinë paradoksale të "botës së re" që po instalonte komunizmi: ndërsa Enveri e kishte nënshtruar Shqipërinë ndaj jugosllavëve dhe i kërkonte Titos të pranonte vendin tonë si republikë të shtatë, Hamiti akuzohej se "kishte hedhur shumë gurë kundër Jugosllavisë motër". Dhe si i shpëtoi pushkatimit nga që ishte i sëmurë, e shfrytëzuan si përkthyes edhe pse ia kishin vrarë pa gjyq vëllezërit e mëdhenj dhe burgosur të motrën. Atë motër, që pasi kishte përfunduar studimet në institutin femëror "Nëna Mbretreshë", kishte vazhduar Universitetin "La Sapienza" në Itali, në Fakultetin e Letrave dhe Filozofisë.

Musineja mbante nëpër mure fotot e Rilindasve tanë si Naimi, Samiu, Vreto, Veqilharxhi, De Rada, Hoxhi e Kolea me shokë, ajo lexonte veprat e shkrimtarëve atdhetarë, por edhe kolosët e letërsisë së huaj si Dante, Petrarka, Gëte, Longfellow, Balzaku, Dikensi, Tolstoi, Çehovi, Turgenievi, Pirandelo, Vergas, Gorki, si dhe filozofët e mëdhenj, Niçe, Spinoza, Volteri, Kanti, Spenser, Shopenhauer etj. E mrekullonte ajo çka Italia trashëgonte nga historia, arti, arkitektura, letërsia, muzika, por ishte e papajtueshme me fashizmin që kërkonte ta mbyste lirinë dhe ishte bërë fuqi agresore, derisa kishte pushtuar

## REFLEKSIONE

- *Libri i saj i parë “Si më thotë nënua plakë” tërhoqi vëmendjen e lexuesve të shumtë dhe parafoli se një shkrimtare me shumë perspektive po vinte te ne. Vetë Lasgush Poradeci është shprehur me shumë konsideratë për Musinenë. Ai e quan “Si më thotë nënua plakë”: “Një përshkrim i gjallë, realist dhe një rrëfim i freskët plot ngjyrë, plot shije, i nxjerrë krejt dhe befas nga momenti natyral i burimit të tij”.*

# MUSINE KOKALARI MODELI I FJALËS SË LIRË TË INTELEKTUALIT

## MUSINE KOKALARI LETËRKËMBIME, SHËNIME, KUJTIME

Përgatiti: Bibika Kokalari



(Vijon nga faqen 8)

edhe atdheun e saj. Për më tepër, ajo kishte nisur të shkruante vetë tregime, ku e nxiste profesor Xhuvani, artikuj publicistikë, e të bënte përkthime.

Libri i saj i parë “Si më thotë nënua plakë” tërhoqi vëmendjen e lexuesve të shumtë dhe parafoli se një shkrimtare me shumë perspektive po vinte te ne. Vetë Lasgush Poradeci është shprehur me shumë konsideratë për Musinenë. Ai e quan “Si më thotë nënua plakë”: “Një përshkrim i gjallë, realist dhe një rrëfim i freskët plot ngjyrë, plot shije, i nxjerrë krejt dhe befas nga momenti natyral i burimit të tij”.

Për krijimtarinë e saj janë shprehur me simpati edhe personalitete të kulturës italiane, aq sa gjuhëtari i njohur Carlo Tagliavini pohon se e ka lexuar, rilexuar dhe vazhdon ta lexojë librin e saj. Në këtë pikë, autori Butka jep edhe përshtypjet e studuesve dhe kritikëve të sotëm shqiptarë.

Ja fjala vjen, se si shkruan shkrimtatri ynë Visar Zhiti për veprën e saj në përgjithësi: “Musine Kokalari ka një meritë të veçantë për begatimin e letërsisë shqiptare, duke krijuar një tip të ri zhanri, të dallueshëm e origjinal dhe të pangjashëm me asnjë shkrimtar tjetër në fund të viteve 30”.

### EDHE AJO KISHTE DHE DËSHIRA DHE ËNDRRA TË MOSHËS

Por Musineja, vajzë e re, patjetër që kishte dhe dëshira dhe ëndrra të moshës. Botën e saj të brendshme, ndjenjat e saj të natyrshme, trazirat intime, Uran Butka na i përshkruan mjaft bukur te dashuria e pastër, por dhe e dështuar e saj, me një djalë italian, që ishte diplomuar në shkencat politike, i cili shkon diku si ushtar për të luftuar. Para syve na shfaqet një ndeshje midis dashurisë dhe parimeve. Ata duheshin, por parimisht ishin kundërshtarë. Prandaj te Musineja, triumfon arsyeja, pra parimet e palëkundura të saj dhe sidomos dinjiteti që nuk pranon nga askush përbuzje si e huaj. Ajo krenohet se është shqiptare, deri edhe para atij kolonelit që takoi në tren, i cili kërkonte ta bindte se po e pushtonin Shqipërinë për ta civilizuar. “...s’jua kemi kërkuar, të na civilizoni me anë të pushtimit. Ne të rinjtë po mësojmë dhe po ne do ta civilizojmë vendin tonë...”, ia përllas atij. Dhe kur koloneli i thotë se ju jeni prapa botës, ende me karroca, ajo i përgjigjet: “Kjo nuk është një arsye që pushtimin ta quajmë shpëtim”. Pikëpamjet e saj përparimtare, në zymtësinë dhe ngatërresat e asaj kohe, Musineja, nuk i fshehu as në shtypin shqiptar. Madje edhe pas çlirimit ajo e ndieu se duhet ta ngrinte zërin akoma më shumë. Kjo qe dhe arsyeja, që duke parë se këtu gjithçka tregonte se po vendosej diktatura dhe po i mbyllej goja me dënime dhe raprezalje, atyre që kishin bindjen që e formuloi aq mirë Harry Belafonte: “Mospajtimi i mendimeve është themelor në secilën demokraci”.

Kjo qe dhe arsyeja përse Musineja, ajo vajza dikur e ndrojtur dhe e heshtur, tani qe kthyer në një luftëtare për mendimin pluralist, duke iu futur politikës, edhe pse e dinte se kjo qe një ndërmarrje mjaft e rrezikshme. E qartë në atë që do të bënte, ajo organizoi me rastin e zgjedhjeve, një grup opozitar, për të konkuruar dhe pastaj populli le të vendoste. Por nuk e kishte atë mendje Enver Hoxha me të vetët; në shembullin e monstrës Josif Stalin ai e kishte ndarë mendjen, për të mos e ndarë me askënd pushtetin.

Mjaftoi kjo që kalvari i vuajtjeve dhe torturave të asaj nëpër hetuesira, gjyqe e internime, madje edhe pasi internimi, pas viteve të gjata, përfundoi të ishin sa brutale aq çnjerëzore. Mendoni të kishe punë me xhelatë si Nevzat Haznedari... Asnjë mëshirë për një grua që e donte me gjithë zemër atdheun dhe popullin e saj. Vetë Enveri, shprehej se donte ta zhdukte, por kjo nuk ishte e lehtë për një njeri si ajo? Vetë ai shkruan në kujtimet e tij se nuk na ka dërguar “asnjë letër, asnjë falje dhe preferoi burgun”.

### SI MUND TË KËRKONTE FALJE, PA PASUR AS MË TË VOGLIN FAJ AJO TRIMËRESHË?

Po si mund të preferonte burgun një shpirt i lirë si Musineja, në kulmin e moshës? Gjithashtu, si mund të kërkonte falje, pa pasur as më të voglin faj ajo trimëreshë? Dhe tani të mendosh: Enveri nuk kurseu gati të gjithë ata burra drejtues të shquar



në luftë, heronj, deputetë, anëtarë të Byrosë Politike dhe Komitetit Qendror, ministra, e kryeministra, që u dha nga një plumb pas koke, pa iu dridhur qerpiku, dhe pa e vrarë fare ndërgjegja e tij prej Neroni, dhe nuk arriti të zhdukte një grua delikate, pa asnjë lloj pushteti dhe krejt të pambrojtur si Musine Kokalari.

Sikur vetëm këtu të ndaleshim dhe të arsyejonim, ishte mëse e mjaftueshme për të kuptuar se nga çfarë brumi ishte gatuar dhe çfarë personaliteti i papërkulur kishte ajo. Musineja mbeti deri në fund, ashtu sikurse thosh Friedrich Schiller: “Jini të fisëm në shpirt! Është zemra ajo që e ndërton dinjitetin tonë, dhe jo opinionet e të tjerëve”. Më thoni tani; përballë stoicizmit të saj, dhe madhështisë morale që tregoi, cili është dinjiteti i atyre që e prangosën, e spiunuan, e akuzuan, e përbuzën, e shanë, e ofenduan... Përse të gjitha këto? Vetëm pse pranoi hapur se kishte përpiluar një kërkesë, drejtuar aleatëve për të shtyrë zgjedhjet, ku të merrnin pjesë edhe katër grupet opozitare. A nuk janë lapidare fjalët e saj në gjyqin ushtarak (!), që i kurdisën, ku e dënuan me 20 vjet burg: “Unë nuk kam nevojë të jem komuniste që të dua vendin tim. E dua vendin tim edhe pse nuk jam komuniste... Ju jeni duke më ndëshkuar për idealet e mia!”

A nuk të kujton kjo vajzën e Orleanit, shenjtoreshën e shpallur në vitin 1920, Zhan d’Arka, para turrës së druve kur ishte vetëm 19 vjeçe? Nga ana tjetër, nuk duhet harruar, se njësoj u trajtuan sa e sa gra të tjera, si Sabiha Kasimati, Drita Kosturi, Marie Medicina, Raile Luzi, Qefsere Begeja, Hava Golemi, Lavdie Petrela, Rita Koka, Jolanda Tafmizi, Nuriye Koculi me shoqe.

Musineja, tekta të ëmës i kishte ardhur, fundi i drejtohet: “Ti, Ane, edhe baltën do ta hidhërosh me ato që ke hequr”. Sa domethënëse që është kjo shprehje, e cila përmbledh tmerret që hoqën mija e mija Ane të ndershme shqiptare. Mallkimi rëntë mbi ata që ua nxinë jetën atyre, që e varfëruan deri në kufijtë e mjerimit një popull të tërë, dhe turpi rëndoftë mbi këdo që i del djallëzisht në mbrojtje diktaturës dhe diktatorit. Nder njerëzve të mençur e atdhetarë si Uran Butka që duke ndriçuar figura të tilla, i bëjnë nder të vërtetës! Intelektualë, thojeni fjalën tuaj si ai, dhe kujtoni se shprehja e politikanit filozof Alexis de Torqueville se “Shtypi është mjeti më i pa të metë dhe më demokratik i lirisë”, vlejnjë edhe për ne. I asaj lirie, të cilës bija e Gjirokastrës dhe e gjithë Shqipërisë, Musine Kokalari i kushtoi gjithë jetën e saj!

## IN MEMORIAM

*Elham Sulejman Elezaj ishte dhe ngeli përjetësisht një oficer policie special trim i pashoq, ndër më të aftët profesionalisht*

## ELHAM ELEZAJ DËSHMORI LAB QË SHKROI HISTORI KRENARIE NË POLICINË E SHTETIT



Prof. Asoc. Dr. Zaho GOLEMI

### NË RRËNJËT E ORIGJINËS SË OFICERIT TË POLICISË SHQIPTARE

Në gjithë rrethin e miqve, shokëve e kolegëve kur flasim për Elham Elezin, kujtojnë një djalë trim të guximshëm e profesionist të Policisë së Shtetit, një dëshmor të shpallur ligjërisht por me tiparet e plota të një heroi, krenarie dhe dinjiteti, një djalë që ka ngelur krenari brezash dhe frymëzim për vijuesit e misionit të shenjtë dhe fisnik të organizatës së madhe të Policisë së Shtetit. Elham Elezaj erdhi në jetë 46 vite më parë në fshatin Hysoverdhë të Vlorës, por që rrënjët e origjinës familjare i kishte në fshatin historik të Kallararit. Ai erdhi në jetë në një familje me tradita atdhetare, që kishte bërë emër në fshat dhe në krahinë, në gjithë lumin e Vlorës. Elham Elezi ishte lindur më 27 korrik 1969, në Hysoverdhë të Vlorës, në një familje kallaratase. Arsimin fillor e kreu në shkollën "Dalan Mehmeti", ndërsa arsimin tetëvjeçar e të mesëm të përgjithshëm i kreu në shkollën "Eqerem Beqiri", në lokalitetin e Kotës. Që në fëmijëri u edukua me frymën atdhetare e patriotike sepse në oxhakun e tij familjar ka pasur shumë të rënë për lirinë dhe pavarësinë e Atdheut dhe gjaku i derdhur në themelet e pavdekësisë kombëtare është amanet në breza për shqiptarët. Nga të dhënat e burrave më të vjetër të krahinës që i flasin epokave dhe që kërkojnë të lidhin brezat me të vërtetat historike: "...një oxhak i njohur me rrënjë në Kallarar janë edhe "Elezajt". Rrëzë malit të Bogonicës janë rrënojat e fshatit të djegur nga anadartët grekë të 1914-ës. Kjo trevë dhe fshatrat përreth i ka folur shekujve me gjuhën labërishte, kur e ka kërkuar historia edhe me gjuhën e armëve kundër çdo lloj pushtuesi. Në këto troje dhe jo vetëm përballja me pushtuesit, të qenit luftëtarë ishte detyrim për mbijetesë dhe zanaq të trashëgohej nga rrënjët stërgjyshore". Elezajt janë një fis i njohur jo vetëm në Kallarar, por kudo ku kanë qenë dhe që kanë lëvizur me bagëti dhe punë të tjera nëpër trevat labe dhe më gjerë. Nga ana tjetër sa herë e kërkonte situata luftarake rrëmbejnë armët dhe bëheshin bashkë për mbijetesë, për amanetin e të parëve trupëzoheshin me lirinë. Elezajt merituan nderimin respektin jo vetëm në fshat por dhe në krahinë dhe më gjerë. Ata kanë qenë bashkë në të gjitha luftat për liri e pavarësi. Të parët e oxhakut "Elezaj" janë me emër kanë luftuar për mbrojtjen e tyre, për të drejtat, pjesëmarrës në kryengritjet masive antitanzimat më 1847 kundër pushtuesve osmanë, kanë dhënë kontribut në katër luftat për mbrojtjen e kryeqendrës së jugut të Janinës, janë gjakosur në luftë me andartët e 1914-ës, në Luftën e Vlorës, që u bë masive e kombëtare pasi morën pjesë 89 çeta luftëtarësh dhe bënë të mundur kthimin e truallit të pushtuar dhe mundësuan pavarësinë e dytë të Shqipërisë më 1920-ën. Ndërkohë që Elezajt shkruan epope lavdie gjatë viteve të Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare, pasi dhanë gjak për lirinë e Atdheut. Në këtë truall lindi Elhami biri i Sulejman Çerem Elezi dhe Antigoni Izet Sheraj (nga Bolena, por rritur në Vajzë të Vlorës). Sulejmani dhe Antigoni krijuan një familje të madhe dhe të denjë, duke sjellë në jetë gjashtë fëmijë: Elhami, Leonardi, Albani, Miranda, Esmeralda dhe Shaipi. Elhami ishte gëzimi i parë, që shpejt u bë krah familjes dhe në moshën e burrërisë u martua me Elvira Biraku/Elezaj dhe sollën në jetë një vajzë Sodorela Elham Elezaj që ka sot një djalë dhe një vajzë, Xhoel dhe Melodi (që janë nipi dhe mbesa e dëshmorit Elhami Elezaj).

- Në përkujtim të efektivit të RENEA-s, djalit trim të Labërisë komandantit profesionist oficerit Elham Elezaj (27.7.1969 -9.7.1998), dëshmorit të Atdheut, që ngeli krenari dhe frymëzim për brezat e organizatës së madhe të Policisë së Shtetit. Elham Sulejman Elezaj është shpallur me titullin e lartë "Dëshmor i Atdheut" me vendim nr.229 datë 13.4.1999, titull që në bazë të ligjit "Për statusin e Dëshmorit", është njohur me vendim nr.15 datë 31.10.2003 të Komisionit Qendror të statusit "Dëshmor i Atdheut" pranë Ministrisë së Mbrojtjes, vendim që është shoqëruar me certifikatë dëshmor si dhe më flamurin "Familje Dëshmorit".



### TRE DËSHMORË TË ATDHEUT TË OXHAKUT TË ATDHEUTARISË "ELEZAJ"

Për të nderuar dëshmorin e policisë së shtetit Elham Elezaj morëm takim me babanë e tij Sulejmanin, pjesë e një familje me rrënjë dhe me degë atdhetare, një familje me të shkuar patriotike nga gjyshi e stërgjyshi, nga rrënjët kallaratase me histori të madhe në trevën e lumit të Vlorës, por me histori të njohur në rang kombëtar, pasi lavdinë dhe krenarinë në të gjitha luftat e shqiptarëve kundër pushtuesve "jua hiqte pragu", sikurse gjithë Kanonisë/Labërisë.

Por luftat kanë pasur edhe të rënë që gjakun nuk e kanë kursyer për Atdhe dhe kanë vaditur pemën e madhe të lirisë sonë kombëtare. Nga të dhënat e Sulejman Elezaj mësojmë edhe më tepër për rrënjët e kësaj familje të njohur në fshat dhe krahinë. Kështu, i lindur dhe rritur në një truall të ashpër gjeografik por atdhetar Shuaip Mahmut Elezaj ishte martuar me Medhuri Neim Bocaj (Elezaj) nga fshati Ramicë. Të dhënat flasin se në fund të shekullit të 19-të dhe fillim të shekullit të XX-të, ata sollën në jetë katër djem dhe një vajzë: Çerem, Zyber, Amdri, Nexhip dhe vajza Sulote (e cila u martua në Ramicë me Ali Brahim Bocaj dhe pati 7 fëmijë, ku djali i madh Myftar Ali Bocaj doli partizan dhe ngeli pishtar lirie dëshmor i LANÇ-it pasi mbeti përjetësisht në betejën tek Qafa e Gjarpërit). Në Labëri dhe sot e kësaj dite për ato vatra që kanë derdhur gjak për Atdheun në periudha të ndryshme thuhet, "shtëpi luftime", nderohen, respektohen dhe u shprehët mirënjohje për brezat pasi janë dhe mbeten ajaka e atdhetarisë shqiptare.

Ndërkohë që të tre djemtë e Shaipit u përbashkuan me formacionet partizane, luftuan në të gjitha betajat e përgjakshme të BrVS "heroinë e Popullit", dhe gjakun

nuk e kursyen për lirinë e Atdheut. Kështu Zyberi, Amdri dhe Nexhip Shaip Elezaj janë që të tre dëshmorë, ku në dokumentacion janë shënuar me mbiemrin "Shero" ose "Sheraj" edhe pse në fakt janë që të tre nga oxhaku "Elezaj", nga kjo derë e rëndë emërdritur e Kallararit historik, që pavarësisht se pasardhësit u vendosën edhe në Hysoverdhë, edhe më vonë në Kotë për disa vite ata mbajtën lart origjinën stërgjyshërore të kallarataseve, që kanë një devizë edhe sot e kësaj dite: "Ec ngado po Kallaratin mos e harro"! I biri i Çeremit, Sulejmani e mbajti lartë emrin e të parëve, nderoi dhe respektoi gjakun në tre xhaxhallarëve dëshmorë të LANÇ-it, por që prej vitit 1998 edhe një copëz e shpirtit të tij derdhi gjakun për rend dhe siguri publike në vendin tonë, pasi djali i madh i tij Elhami ngeli përjetësisht në altarin e kombit shqiptar me emrin e madh "Dëshmor", ku mirënjohja e brezave në vijimësi do të jetë e përjetshme. Nga të dhënat në departamentin e Dëshmorëve pranë MM, por edhe në librin zyrtar të MM-së të publikuar me rastin e 100 vjetorit të krijimit të shtetit shqiptar evidentohet: "Zyber Shaip Sheraj/Elezaj, kishte lindur në Kallarar më 1916, rënë më 1946 (BrVS) në Mavrovë, është shpallur dëshmor i Atdheut, me Vendim nr.2 datë 7.1.1972, të Komitetit Ekzekutiv të KP të rrethit të Vlorës. Amdri (Hamdi) Shaip Sheraj/Elezaj, kishte lindur në Kallarar më 1920 dhe rënë më 1944 në Mavrovë (BrVS), është shpallur dëshmor i Atdheut, me Vendim nr.209 datë 29.7.1979 të Komitetit Ekzekutiv të KP të rrethit të Vlorës.

Nexhip Shaip Sheraj/Elezaj, kishte lindur në Kallarar më 1923 dhe rënë më 1944 (BrVS) në Salari, është shpallur dëshmor i Atdheut, me Vendim nr.97 datë 22.9.1972, të Komitetit Ekzekutiv të KP të rrethit të Vlorës. Sulote Shaip Elezaj (vajzë kallaratase) martuar me Ali Boçi nga fshati Vajzë sollli në jetë shtatë fëmijë. Djali i madh i saj Myftar Ali Boçi i lindur në Ramicë më 1922 dhe ra dëshmor në betejën e njohur të Qafës së Gjarpërit gjatë LANÇ-it dhe është shpallur me titullin dëshmor i Atdheut me Vendim nr.97 datë 22.9.1972, të Komitetit Ekzekutiv të KP të rrethit të Vlorës. Nga dera partiotike e Elezajve ka të evidentuar edhe "Elham Sulejman Elezaj është lindur më 27 korrik 1969 në Hysoverdhë (me origjinë nga Kallarar) ka rënë më 9 korrik 1998 në Tiranë, shpallur me titullin e lartë Dëshmor i Atdheut me vendim nr.229 datë 13.4.1999; ndërkohë që titulli "Dëshmor i Atdheut" është njohur me vendim nr.15 datë 31.10.2003 të Komisionit Qendror të Statusit Dëshmor i Atdheut pranë Ministrisë së Mbrojtjes në Tiranë.

### KARRIERË E SHKURTËR ME OPERACIONE TË SHUMTA POLICORE NË PËRBALLJE ME KRIMIN

Elham Sulejman Elezaj ishte dhe ngeli përjetësisht një oficer policie special trim i pashoq, ndër më të aftët profesionalisht, me guxim e zell të pa përshkruar, djalë Labërie i paepur para vdekjes, i lindur për t'u sakrifikuar në emër të detyrës, shpërfillës para rrezikut, i shoqëruar me kolegët, me ndjeshmëri të lartë për hallet e bregatave të tyre, që gëzonte respektin e dashurinë e të gjithë specialëve, policë e oficerë. Biri i fshatit Hysoverdhë me rrënjë kallaratase ishte pasionant për automekanikën, duke u bërë mjeshër zanaçi në guidimin e çdo lloj automjeti. Ai kishte zhvillim fizik shumë të mirë, ose sikurse i thonë në Labëri, "djalë mali", pëlqente të luante futboll, ishte lab ëndërrimtar për të vijuar karrierën ushtarake. Dega ushtarake e Vlorës nisur nga të dhënat familjare, por edhe kondicioni i fuqishëm fizik e përzgjedhja Elham Elezaj duke e mobilizuar si ushtar në repartin e policisë nr. 324, i quajtur dhe "batalioni i sigurimit i Ministrisë së Punëve të Brendshme".

(Vijon në faqen 12)

**IN MEMORIAM**



(Vijon nga faqja 11)

Ai kreu me sukses shërbimin e detyrueshëm ushtarak/ policor dhe më tej shërbeu edhe si shofer aktiv edhe në shërbime. Miqtë e tij të ngushtë e kujtojnë për veprimin energjik në digaster, edhe ditën që u sulmua godina e klubit të këtij dikasteri, më 29.5.1991, kur me guxim diti të përballonte valën e demonstruesve, si dhe të bëhej mburojë të pronës shtetërore përballë atyre që kërkonin të shkatërronin objektin duke i vënë flakën. Një vit më vonë në nëntor 1992 u pranua në repartin nr.88, caktuar “shofer trupe operacionale”, ka qenë pjesëtar në shumë operacione me shkallë të lartë vështirësie, ndër të cilët përmendim, ndërhyrjet e tyre në Valbonë, Korçë, Vlorë, Shkodër dhe në të gjithë Shqipërinë. Më tej u caktua duke u përzgjedhur edhe në grupin e sigurimit të ministrit të Brendshëm.

Elhami ka përbulluar rreziqe të shumta në jetë edhe kur ishte me shokë në një shërbim në segmentin ura e Bunës - ura e Bahçallëkut, në dhjetor 1993, kur një grup kriminal iu kundërpërgjigj me zjarr thirrjes së specialeve në një pikë kontrolli, të cilët u vunë në ndjekje dhe plumbat goditën makinën e policisë duke i këputur tubin e naftës dhe e detyruan të ndalej, çfarë ishte fat për grupin, duke mos mundur ti dëmtonin. Për aftësi dhe zotësi meqenëse vendi pati probleme të mëdha me kanabizimin, në vitin 1994 kaloi në njësinë “antidrogë”, ku vijoi pa shkëputje nga puna edhe arsimin e lartë policor në Shkollën e Saukut, ku edhe u titullua oficer policie në vitin 1997. Në ngjarjet e periudhës 1996-1997 ka qenë shumë aktiv në shërbime speciale, përfshirë këtu pjesëmarrjen në lirim dhe një politikani të marrë peng në Lushnjë, në janar 1997, në tentativat e dështuara të qeverisë për rivendosjen e rendit në Lushnjë; për nxjerrjen nga Vlorë të punonjësve të plagosur të SHIK-ut, të cilët kishin mbetur të strehuar në Vlorë. Në rrjedhën intensive të jetës policore të asaj periudha Elhami u rikthye në “RENEA” në verën e vitit 1997. Ai u emërua në detyrën e komandantit të grupit të zhytjes, ndërkohë që profesionalizmi i tij ishte rritur dhe konsoliduar edhe me shërbime të shkallës së lartë dhe të jashtëzakonshme. Reparti i “RENEA-s”, në këtë periudhë pati një barrë të madhe në hapjen e akseve rrugore të bllokuara nga bandat kriminale në rritje, por dhe në mbështetjen e shërbimeve të policisë në të gjithë vendin për kapjen e elementëve të armatosur; ringritjen e komisarëve të Policisë të shkatërruar nga viti i mbrapshtë i 1997-tës për shkak të falimentimit të firmave piramidale. Rivendosja e rendit në rrethet problematike, shpartallimi i bandave që kishin uzurpuar portet, doganat, akset rrugore apo kishin vendosur hegjemoninë e tyre në territore ku nuk guxonte të hynte asnjë shërbim policie, e bënte më së miri repartin ku bënte pjesë edhe Elhami. Ai ka qenë pjesë në shërbimet që ndërmorën specialët në Vlorë, që filloi më 10.8.1997, dhe tregoi trimëri, guxim e zotësi në goditjen e shpartallimin e bandës së Çoles, në goditjen e bandave të tjera, që mbanin emrin e kërreëve të grupeve ku përmendeshin “Gaxhai”, “Mukajt” apo “Xhelitët”, ishte pjesëmarrës në një operacion shumë të vështirë në Cërrik të Elbasanit në përballje me bandat ku ka pasur edhe shumë humbje jete.

Elham Elezaj në emër të detyrës gjithmonë i gatshëm në çdo aksion ka treguar guxim të madh në të gjitha operacionet policore në të gjithë vendin. Janë për tu përmendur veçanërisht operacionet e Policisë së Shtetit në veri të vendit e sidomos në shërbimet e kryera në Shkodër, në 18-21.1.1998, kur u rebeluan disa punonjës policie, kur u mor peng edhe prefekti Gëzim Podgorica dhe u plagosen specialët Genc Hoshafi dhe Sokol Shepeteja. Një nga ngjarjet më të veçanta është hyrja në Shkodër, duke zbritur me helikopter në kodrat e Tepes, kur u “zaptua e u djeg qyteti” nga njerëz me maska dhe Elhami ishte në krye të grupeve që krahëmorën kurrizit të kodrës së kalasë për rrethimin e kapjen e personave të armatosur, një veprim shumë i guximshëm dhe me rrezik të madh. Ndërsa sipas dëshmimeve të komandantit të tij Hilë Lushaku, veprimet energjike të grupit të tij në ngjarjet e datave 22 dhe 23.2.1998, në kodrën e Tepesë

(edhe vetë fjala “tepe” do të thotë kodër), ishin vendimtare në thyerjen e qëndresës së kriminelëve dhe lehtësimin e veprimeve të grupeve të tjera të Forcave Speciale e atyre të Ndërhyrjes së Shpejtë, që sulmonin përballë për kalimin e urës së Bahçallëkut. Grupet e guximshme të policisë kapërcyen me sukses edhe tetë pengesa xhëniere të vendosura në këtë rajon si dhe të kombinuara edhe me ngarkesa me lëndë plasëse. Janë me dhjetra veprimet e Policisë së Shtetit, ku Elhami ishte gjithmonë pjesë e dorës së fuqishme të shtetit për të rivendosur rendin dhe qetësinë publike në Shqipëri. Në këto veprime shumë gjak i policisë, gjak i shtetit u derdh për rend dhe qetësi publike.

Ngjarja që i mori jetën Elham Elezaj ishte ajo kur në një ngjarje pengmarrjeje u bë aktivizimi i “RENEA-s” që mundësoi lirim dhe shtatë pengjeve, pjesëtarë të një familjeje. Në këtë operacion mbeti i vrarë Elham Elezaj dhe u plagos special i Adhurim Ceka, si dhe u vra pengmarrësi, polic në repartin e ruajtjes së objekteve në Tiranë. Kështu ishte pikërisht mbasditja e datës 9.7.1998, kur në zonën e “Varrit të Babit”, Elhami humbi jetën tragjikisht jetën në një operacion policor për kapjen e një personi të armatosur, që kërcënonte me jetë njerëzit e marrë peng.

Sikurse mësojmë nga ish-Komandant i Repartit special Vasillaq Sota: komandant i repartit ka qenë Artan Didi, ndërsa në grupin e ndërhyrjes në ditën e aksionit ishin: Elham Elezi komandant njësie, Ardian Dibra, Vladimiro Doko, Adhurim Ceka i cili u plagos në këtë aksion. Pjesa tjetër e grupit ka qenë në kufizim. (Para transferimit të RENEA Elhami ka shërbyer për katër vite në një Repart Special (Rep spec 77 Tiranë) ose Antidroga 1994-1997 ku dallohej për trimëri zgjuarsi dhe itegritet. Në ditën e aksionit, ndërhyrja e Elhamit ishte fatale, pasi i mori jetën atij në lulen e rinisë, në kulmin e energjive duke e shndëruar atë në të pavdekshëm në legjendë dhe hero, duke ngelur në përjetësi në altarin e trimërisë e etiketuar, “komandant Elham Elezaj trimi i vendosur dhe besnik, që mbrojti me gjakun e tij me jetën e tij jetë e të tjerëve dhe merituar mirënjohjen mbarëpopullore”. Ai ishte dhe mbeti një oficer policie shembullor, një polic i lindur i veshur me vetitë dhe vitytet më të larta njerëzore, një trim që si trembej syri kurrë, aq sa shokët e tij thoshin një maksimum proverbiale labe me shaka: “këtë djalin lab sa ha plumbi”. Por plumbi i pabesisë dhe i kimit ka marrë shumë jetë të organizatës së Policisë së Shtetit.

Elham Elezi kaloi me sukses të plotë operacionet më të vështira të viteve të mbrapshta 1997 dhe 1998, ndoshta vitet më të trazuara të shekullit në aspektin e brishtësisë së rendit dhe të sigurisë. Por ai humbi jetën në një operacion për ndalimin e një ish-policit të dehur dhe me probleme të mëdha. Shokët e tij të armës policore e kujtojnë vazhdimisht për mirësinë njerëzore që rrezatonte me shokët e kolegët, me vartësit që i kishte shokë besnik në çdo operacion, që realisht kanë qenë të shumta dhe me shkallë jashtëzakonisht të lartë rrezikshmërie. Si një repart elitare dhe me unitet mendimi dhe veprimi djemtë e RENEA-s, i bënë homazhe dhe e përcollën shokun e tyre më 10 korrikun e 1998-tës tek ish-SHQUP-i buzë lumit Lana. Elham Elezaj ka qenë i martuar me Elvirën nga Skrapari si dhe ka lënë një vajzë Sidorelën. Sidorela pas humbjes së babait dëshmor (ndërkohë që kanë kaluar 27 vite nga ajo kohë) ka sjellë në jetë një djalë dhe një vajzë që janë nipi dhe mbesa e dëshmorit.

Elham Elezaj, ky djalë trim i specialeve, profesionalisht me guxim e zell të madh, paepur para vdekjes, i lindur për t'u sakrifikuar në emër të detyrës, shpërfillës i çdo rreziku, me ndjeshmëri të lartë për hallet e brenat shoqërore gëzonte respektin e dashurinë e të gjithë specialeve, policë e oficerëve. Kështu që pas rënies në krye të detyrës u preh për pak kohë në varrezat e Tufinës, por me shpalljen e tij me titullin e lartë Dëshmor i Atdheut, vëndprehja e tij do të ndryshonte dhe do të vendosej ku kishte shokët, ku prehen dëshmorët e Atdheut. Kështu më 5 maj 2022, eshtrat e tij, së bashku me ato të Rifat Cukut e Rifan Hakramës, u varrosen me ceremoni zyrtare shtetërore në “Varrezat e dëshmoreve të Atdheut” në Tiranë. Djem si Elhami i dhanë emër dhe famë repartit

special “RENEA”, (Reparti i Neutralizimit të Elementit të Armatosur), një repart mjaft i njohur në Shqipëri, për garancinë dhe sigurinë që ofron dhe për zgjidhjen e situatave më të vështira në vendin tonë. Për këtë flasin veprat, operacionet, të rënë dhe të gjitha këto duhen shkruar, pasi sikurse thotë një postulat i lashtë romak i gadishullit të apenineve: “verba volant, scripta manent”,/(fjalët i merr era, e shkruara mbetet).

**VLERËSIMI PËR DËSHMORËT ËSHTË VLERËSIM PËR NDERIN DHE LAVDINË E SHQIPTARIZMËS**

Shokët, miqtë e kolegët e Elhamit përbashkohen në mendime dhe vlerësime për shokun e tyre dëshmor, kur thonë: “Respekte dhe vlerësimet më të larta për Elhamin, djalin lab me cilësi të veçanta, shok besnik dhe i shkëlqyer me virtyte besnikërie e trimërie, me guxim që vetëm heronjtë i kanë...”. Komandanti i tij Hilë Lushaku shkruan: “Dëshmor i Atdheut Elhami Elezi nuk nderohet në përvjetore (me dekorata), sikurse shumë të tjerë, kur nuk rekomandon ndonjë subjekt politik, me nismë nga lart, (pasi nuk ka qenë kurrë militant, ose nuk i ka bërë hije ndonjë Partie...”, por i ka shërbyer me dinjitet vetëm shtetit. Polikseni Shenaj/Danaj e shkreh vlerësimin e saj për dëshmorin e Atdheut në vargje: “Elham Elezaj, o trim i rrallë./ Ti çdo herë në plan të parë./ Djalë i fortë, zemër-luan./ Ty Zoti të desh pranë./ U përfsh në paqe./o ëngjëlli ynë!...”. Ndërsa poeti i policisë Besnik Meta, e përjetësoi dëshmorin Elham Elezaj në vargjet: “Malli më ka marrë./ Këpucët e tim biri./ S'i shoh më tek dera./ të lagura nga shiu./ Të thara nga era./ Malli më ka marrë/ Sa më ka sflitur./ Zemra flakëron/ Shpirti i zhuritur./ Në repart tek shokët./ Bir, të ndje pranë!/ Ata pors prindi/ Të kujtojnë plot mall...”. Në librin zyrtar “Dëshmorët e Atdheut”, të publikuar nga Ministria e Mbrojtjes më 2012-ën në kuadër të 100 vjetorit të krijimit të shtetit shqiptar, në kapitullin “Dëshmorët të Atdheut të rënë në Tiranë pas vitit 1945”, në faqen 170 dokumentohet: “Elham Sulejman Elezaj është shpallur me titullin e lartë Dëshmor i Atdheut” me Vendim nr.229, datë 13.4.1999, lindur më 27.7.1969 dhe rënë në krye të detyrës më 9.7.1998. Vendimi për dhënien e titullit “Dëshmor i Atdheut” i është dhënë pas nëntë muajsh e katër ditësh. Vlerësimet për dëshmorin kanë qenë të rralla edhe pse kontributi i tij në një jetë të shkurtër ka qenë i gjatë dhe sinjifikativ në detyrat më të vështira që ka përbulluar Policia e Shtetit e veçanërisht reparti special i saj “RENEA”. Këtu është për t'u shënuar se Këshilli Bashkiak i Vlorës ka marrë në analizë dhe ka vlerësuar herë pas here edhe ata bij e bija të popullit që kanë shërbyer në Policinë e shtetit por që kanë dhënë gjakun e tyre për mbrojtjen e rendit dhe të sigurisë së qytetarëve në Shqipëri. Kështu më pak kohë më parë një rrugë në qytetin e Vlorës i është dhënë emri i oficerit të Policisë së Shtetit “Elham Sulejman Elezaj”.

Kështu shkruan gazeta “Shqiptarja” që shkruan 30.9.2025: “Një rrugë në qytetin e Vlorës merr emrin e Dëshmorit të Atdheut Elham Elezaj, ish-oficeri i RENEA-s ra në krye të detyrës në moshën 29 vjeçare më 9 korrik 1998. Është një rrugë, pranë stadiumit në Vlorë që do të mbajë emrin e dëshmorit të Atdheut, Elham Sulejman Elezaj. Në ceremoni morën pjesë, përfaqësues të këshillit bashkiak të Vlorës, familjarë dhe ish-kolegët e Repartit RENEA. Suljeman Elezaj, babai i dëshmorit të Atdheut Elham Elezaj duke vlerësuar këtë nismë shprehë: “biri im e dha jetën për Atdheun. Ne jemi familje që në të gjitha epokat kemi dhënë gjak për Atdheun. Kam tre xhaxhallarë dëshmorë të Luftës Nacionalçlirimtare dhe djali im është dëshmor i katërt në familjen tonë. Kemi dhënë shumë për atdheun. E ndje veten krenar që emri i djalit do mbetet këtu në Vlorë ta nderojnë vlonjatët bashkë me ne familjarët”. Emërtimi i kësaj rruge, erdhi si propozim i këshilltarëve të djathtë dhe mori votat unanime në Këshillin Bashkiak të Vlorës.

Në ditën e përmimit të rrugës me emër dëshmorit, Elpiniqi Mërkuri, kryetare e këshillit bashkiak të Vlorës deklaronte: “Është një gjest i vogël por i vyer për komunitetin, për familjen. Qoftë i paharruar dhe e kujtohshim gjithmonë sa herë kalojmë në këtë rrugë, Dëshmorin Elham Sulejman Elezaj”. Kryesia e SHAK “Labëria” ka marrë në analizë të rënë për Atdheun por edhe ata që kanë rënë për vendosjen e rendit dhe sigurisë në vendin tonë dhe rrezultat se një ndër djemtë më të mirë të Labërisë ngelën përjetësisht në altarin e lirisë dhe të shqiptarizmit. Një grup intelektualësh nismëtar ka hartuar edhe procedurat e nderimit dhe të vlerësimit të figurave që meritojnë nderimin dhe nderimin e brezave dhe ka propozuar që ish-oficerit të RENEA-s Elham Sulejman Elezaj (pas vdekjes), t'i jepet titulli “Nderi i Qarkut të Vlorës” me këtë motivacion: “Për kontribut sinjifikativ në mbrojtje të rendit dhe sigurisë publike, për shërbimin dinjitoz në repartin elitare RENEA në ringritjen e sigurisë së brendshme shqiptare, për angazhim serioz e profesional në gjithë operacionet policore në jug dhe në veri të vendit pas vitit të mbrapshtë të 1997-ës, duke lartësuar figurën e punonjësit të policisë nga treva vlonjate, për akte të shumta trimërie e guximi në mbrojtjen e rendit publik në Shqipëri, pa kursyer as jetën dhe gjakun e tij në mbrojtje të qytetarëve”. Biri i trevës fisnike vlonjate ishte dhe ngeli në kujtesën e të gjithëve si shembull guximi, trimërie e heroizmi që nderohet në Vlorën e tij të dashur por dhe në mbarë vendin, në atdhetarinë dhe shqiptarimën.

## IN MEMORIAM

*Humbje për komunitetin akademik, kulturor dhe shoqëror të Gjakovës dhe të Kosovës*

# Profesor Xhevat Koshi, personalitet i shquar i arsimit në Gjakovë e Kosovë

- *Personaliteti i profesor Koshit dallohej për urtësi, maturi dhe qëndrueshmëri morale. Ai mbeti deri në fund një model i qytetarisë aktive, i përkushtuar ndaj së vërtetës historike dhe kujtesës kolektive, duke kontribuar me integritet e seriozitet në çështje me rëndësi publike dhe kulturore...*

**P**ara disa ditësh ndërroi jetë profesori Xhevat Koshi, një personalitet i shquar i arsimit, veprimtar i dalluar dhe intelektual i angazhuar në jetën shoqërore e publike të Gjakovës dhe të Kosovës.

Organizata e Bashkuar e Veteranëve të LANÇ dhe pasardhësve të Shqipërisë dhe Kryesia e Organizatës së Veteranëve të LANÇ shprehin ngushëllimet më të sinqerta për humbjen e profesor Xhevat Koshit, duke nderuar kujtimin dhe veprën e tij të çmuar.

Ndarja nga jeta e profesor Xhevat Koshit përbën një humbje të ndjeshme për komunitetin akademik, kulturor dhe shoqëror të Gjakovës dhe të Kosovës. Ai ishte një personalitet i shquar i arsimit, një veprimtar i përkushtuar i organizatës së veteranëve të LANÇ-it dhe një intelektual që kontribuoi pandërprerë në jetën publike, duke mishëruar vlerat e përgjegjësive qytetare, devotshmërisë profesionale dhe idealit për një shoqëri më të drejtë.

Gjatë gjithë jetës së tij, profesori Xhevat Koshi la gjurmë të thella në fushën e arsimit, ku u vlerë-



sua për profesionalizmin, kulturën pedagogjike dhe përkushtimin në formimin e brezave të rinj. Kontributi i tij nuk u kufizua vetëm në auditor; ai ishte aktiv në organizatën e veteranëve të LANÇ-it të Kosovës dhe pjesë e Kryesisë së veteranëve të LANÇ-it në Gjakovë. Në këtë rol, ai u angazhua fuqishëm në ruajtjen dhe promovimin e vlerave të luftës për liri dhe pavarësi, duke përfaqësuar me dinjitet dhe qartësi intelektuale zërin e brezit që sakrifkoi për të ardhmen e vendit.

Personaliteti i profesor Koshit dallohej për urtësi, maturi dhe qëndrueshmëri morale. Ai mbeti deri në fund një model i qytetarisë aktive, i përkushtuar ndaj së vërtetës historike dhe kujtesës kolektive, duke kontribuar me integritet e seriozitet në çështje me rëndësi publike dhe kulturore.

Me largimin e tij, familja humbi një njeri të dashur dhe të nderuar, shoqëria një intelektual të pjekur e të përkushtuar, ndërsa komuniteti i veteranëve një bashkëveprimtar të palodhur dhe të respektuar

I qoftë i lehtë dheu i Kosovës, për të cilën ai jetoi dhe punoi me devotshmëri.

## REFLEKSIONE

## LIBRI “DEKODIMI KRIMEVE” I BASHKIM DAUTI HISARIT



**Nga Kol.Trifon LLUPO\***

**P**ër genocidin sllavoserb janë shkruar e botuar libra nga autorë të tjerë por, libri “DEKODIMI KRIMEVE” i zotit Bashkim Hisari meriton e do zerë një vend të veçantë në serinë e librave që analizojnë Genocidin ndërshekullor sllavoserb ndaj shqiptarëve të Kosovës, në ish Republikën Federative të Jugosllavisë, e po vazhdon akoma edhe sot e kasaj dite, nga Serbia Millosheviçiane dhe Vuçiqiane, që me egërsinë më të madhe e ushtroi gjatë Luftës për Çlirimin e Kosovës gjatë vitit 1998-1999 por, edhe gjatë ditëve të sotme me forma e mjete të ndryshme. Tashmë dihet që OBVL me Organizatën e Veteranëve të Luftës së Kosovës kanë krijuar dhe aderojnë tashmë në Federatën e Veteranëve të Luftës për Liri e Pavarësi të Kombit Shqiptar, ku edhe zoti Bashkim Hisari është Nunkryetar i Organizatës Veteranëve të Kosovës, kështu që jemi jo thjesht miq, por edhe kontribues në ruajtjen e zhvillimin e propagandimin e traditave më të mira shoqërore, kulturore e të luftës të Kombit Shqiptar.

Prandaj dua ta falenderoj për mikun tonë, autorin e nderuar, politologun, diplomat, publicistin dhe shkrimtarin Hisari për këtë vepër enciklopedike.

Vetë emri i librit, nëse do e shqipërosh, të tregon sikur do të duhet të fillosh një rrugëtim të gjatë për tu njohur me ato ngjarje dramatike që i ka shkaktuar Kosovës genocidi ndërshekullor sllavoserb. Autori tregon se për realizimin e tij i është dashur të bëjë shumë kërkime e shfletime të dokumentave arkivore, dokumentave të ruajtura në bibliotekën e tij gjatë viteve të punës, në funksionet e ndryshme që ka kryer, dhe në memorien e tij brilante sepse zoti Bashkim në shumë ngjarje ka qënë edhe një bashkëkohës okular i këtyre ngjarjeve tragjike.

Duke qënë bashkëkohës okular i shumë prej këtyre ngjarjeve tragjike, të shkaktuara nga genocidi ndërshekullor sllavoserb, që zotit Bashkim ia kanë mundësuar funksionet e ndryshme që ka kryer gjatë jetës së tij, ai sjell ngjarje që të rrenqethin dhe e bëjnë lexuesin që të mos shkëputet nga leximi i librit.

Për dijeni të pjesëmarrësve edhe unë e konsideroj veten se kam qënë një kontribues modest në Luftën për çlirimin e Kosovës, pasi kam punuar në strukturat e ngritura nga Komisariati Lart i Refugjatëve i OKB-ës, UNHCR, i cili u vu në mbështetje të Luftës çlirimtare të Kosovës, duke ngritur e mobilizuar një sistem strukturash në varësi të tij dhe organizata ndërkombëtare siç ishin Word Food Program of UN, Kryqi Kuq Ndërkombëtar, Gjysëm Hëna e fondacione të ndryshme, që unë kisha mardhënie bashkëpunimi me 41 organizata të tilla, që mbështetën Luftën për çlirimin e Kosovës, me mbështetjen financiare e logjistike, nëpërmjet Zyrave të Refugjatëve të ngritura në Shqipëri, në Maqedoni e në Mal të Zi Në këtë organizim unë u transferova nga Bajram Curri, në Zyrën e Refugjatëve në qarkun Durrës, i cili ishte qarku, ku u sistemuan numri më i madh i vëllezërve dhe motrave tona shqiptare të Kosovës, duke u ngritur 5 Qendra-kampe të Akomodimit të Refugjatëve. Ndër të tjera kam e ruaj akoma diagramën e përbërjes tyre sipas moshave dhe seksit.

Shifra totale prej mëse 700 mijë të shpërngulurve nga Kosova në Shqipëri është alarmante, si treguese edhe për këtë Genocid serb ndaj shqiptarëve të Kosovës. Në këtë qark u grumbullua numri më i madh i refugjatëve dhe sipas listave statistikore, të cilat unë akoma i ruaj në bibliotekën time rezulton shifra 130 mijë të akomoduar në Durrës, Krupë, Fushë Kriujë e Kavajë.

Duke qënë në këto detyra unë merja edhe informacionet për situatat luftarake në komunat e Kosovës, ku ndër ngjarjet më të dhimbshme ishte lufta e Kosharës ku forcat paramilitare e ushtria serbe shkaktoi shumë viktima, heronjë të kësaj lufte dhe ja tani i shoh të arkivuara në librin e mikut tim, B.Hisari, një vepër shumëpërmasore kjo që do tju vlejë studuesve, sot dhe në të ardhmen.

\*Nnkryetar i OBVL

## PROZE POETIKE

## Kur i dhashë dorën Tatjana Parllakut



Nga Aqif PUCA

1. E shihja nga larg at zonjë-  
Racë kreshnikësh me Mujë,  
Tanushë e Halilë;  
Brilante dhe fisnikë këmbë e kokë ,  
Prej kur ishte foshnjë –  
Kalvar me vuajtje –  
përvjetë e çdo mot.
2. Te vegj'lit e feniksit,  
Nuk dalin në jetë porsì vezë pëllumbi;  
Ata shtratin e kane mbi shkëmbinj të thepisur,  
Jatak kanë Kolesjanin,  
e shtrojen me acar dhe suferinë...
3. Rrahman Parllaku legjendë !  
Baobabi ! Sa tmerre e dhimbje!  
Sa të dhëmb e sa më dhëmb!  
çfarë nuk ra mbi ty,  
si të ishin indigjenë vampirë ,  
Por çdo e rame prej tyre,  
melhem mbi shpirtin tënd.
4. E shihja dhe pyesja vetenL  
-vallë, nga të kenë ardhë ?  
Prapa asaj butësie dhe qielli plot me yje;  
Lule mali prej Novoseje, Koritnik,  
Rrafsha e Lumës dhe Kallabak,  
Nëpër plagë hodhe shtat ;  
linde prej hyjnie .
5. E shihja dhe pyesja veten :  
A mos prej qiellit një yll ka ra?  
A mos një ylber ka lidh dy brigje?  
Prej tek Molla e kuqe ku linde,  
Nuserove bashkë me yjet,  
E në Torvioll, shtratin kishe !
6. Ato sytë e tua burim mirësie,  
Ai shpirti tënd bëlbëzonte:  
- mëshiroji o Zot!  
Në at shpirt kishte vend për të gjithë,  
ishite burim lumturie  
Edhe per ata që të vranë ,  
a per theqafe ik'n .
7. E çfarë nuk ra mbi at' gjigant?!  
- Por a mund te bjere Korabi !?  
E çfarë nuk ra mbi at bajrak  
- Por a mund te bjere Sharri ,  
Luma , Kolesjani!?

E çfarë nuk ra edhe mbi ty  
moj, e shenjëtëruara Tanë !  
U thinje pa nusëruar,  
mbete drathe(dredhëz) mali.

## 8.

Si nuk e pata at fat,  
Të merrja veç pak prej prushit të tij!  
Me askënd tjetër nuk desha  
as të marr e as të jap gjak,  
Por Rahman Përlaku ishte korife;  
ishite dhe mbeti Mbinjeri.

## 9.

Që në lindje thanë:  
- po vjen edhe një Parllak!  
Sa herë e shihja më ngjante si një mal,  
Me shpate, brinja e gërxhe;  
lugje, lumenj, ahe, bredha e lisa;  
Fusha, bregore dhe lëndina  
-qëndisur ai shtat ;  
Dhe shpirti jot si shkëmbi në Vajkal,  
Të them se je Zgalem është pak,

## 12.

Po ku të gjetën? Ti ishe lulezojë?  
Dua ta di çfarë patën me ty ?!  
Si mund të rrojë zhaba me një shqiponjë !?  
Ata mbi ferrishte, dhe pse Neronë ,  
Dhe ti prej majës së Korabit i bën me hije.

## 13.

E shohTanën dhe sytë s'ia ndaj  
- Sa qenka rrit !  
Unë e dinja se ishte fik –  
Por ajo gjithë nur e dritë !  
Unë mendoja se ishte tharë  
- Kur mbi të shkrepitima ranë !  
Por ajo qenka prap gjallë' !?  
Qenka bli, e qenka ah !?  
Rron or rron , nuk bie mali ;  
Kush bie në gjunjë e pret varri !  
Sa hap sytë dielli  
ma s'pari puth Kolesjanin .  
Mbi tokë ka edhe ronxhobonxho,  
pjella gjoli ,  
Por ka edhe kreshnikë, që i ka lind mali .



gjaku yt mbeti sic ishte  
- tjetër gjak...

## 10.

Të panë dhe me flamurin kuqezi mbi Raishtag.,  
Shkëmb përmbi shkëmb !  
"o flamur gjak , o flamur shkabë"  
Edhe 100 hiena t'u sulë ,  
ti nuk u tute por u hodhe si luan.  
Gjak u bë Drini prej gjakut tënd;  
o maratonomak:  
- sa i Madh !

## 11.

Shihja fytyrën tënde moj Tanë,  
Lule bjeshkatore,  
ëngjëllore dhe e magjishme!  
Kishte dhe rrezatimin e diellit,  
dhe ninullat me hënë,  
Kishte dhe aromë trëndëline në logun e Jutbinës.

## 14.

E shoh Tanën , e s'mund të rri pa e pa,  
Si fusha e Korabit  
me diellin n'dashni kan' ra!  
Të çuan deri buzë varrit dhe ulërinë:  
-Hyyyr! Por edhe varri paska shpirt;  
Se kush do rrijë , e kush do të hyjë ;  
Se kush do shkojë në parajsë ,  
e kush në ferr?!  
- E di vetëm unë – tha Hyu;  
Ty të la përjetë në blerim,  
e ata varri i përpiu . . .

## 15.

Sa shumë Brutë paska ky vend ,  
me kamë (thikë) fshehur !  
Edhe Makbethë , edhe Ledi Makbethë !  
Ju kaluat nëpër 9 rrrathë ferri,  
Dhe dolët siç del feniksi nga hiri ....

## SUPLEMENTI LETRAT

# HYSEN DIZDARI NJË LIBËR ME VLERA TË LARTA ATDHETARIE

*“Gjergj Kastrioti Skënderbeu në pullat shqiptare 1913 – 2023”*



*“Jam nisur të mbetem vërtet një kabanë,  
Aspak s’ tingëlloj e s’gjëmoj po s’më ranë.  
Më bini, ju lutem, përherë e ngaherë,  
Në doni prej meje gjënim e poterë.”*

*Dritero Agolli.*

*Poezia “Lutja e kabanës”*



Në vitin 2017, u vunë në qarkullim disa pulla me vlera të ndryshme, të titulluara “Arti Shqiptar-Vizatimi”. Në këtë rast është për t’u lavdëruar puna e studimore e autorit, ku herë pas here shënon jo vetëm datën dhe vlerën e pullave, por edhe cilësinë grafike të tyre, si një lloj jehone të artit shqiptar, kushtuar periudhës së luftës për liri, udhëhequr nga Skënderbeu.

Bindemi lehtë po të vërejmë me kujdes shkrimin ku shënohet shkurtimisht: “Veçoria e këtij emisioni është se të gjitha pullat e bashkuara së bashku, japin pamjen e plotë të pikturës së quajtur “Përballimi”, e cila sot ndodhet e ekspozuar në Muzeun e Gjergj Kastriotit-Skënderbeut, në qytetin e Krujës”. Punë e piktorit Naxhi Bakalli. Faqe 68.

Në fund, dua të veçoj dhe të vlerësoj katër faqe, ku përmbledhen dy kapituj që i japin librit vlera dhe besueshmëri shkencore:

1. Literatura filatelike. 2. Literatura shkencore.

Vetëm studimi i këtyre botimeve, në kohë dhe autor të ndryshëm, është lodhje, mundim e durim shkollor dhe vullnet shkencëtar, për autorin Hysen Dizdari, i cili për hir të së vërtetës ia ka kushtuar të gjithë veprimtarinë jetësore, kërkimit dhe grumbullimit të botimeve kushtuar heroit tonë Kombëtar Gjergj Kastrioti Skënderbeu. Ndaj nuk kursehet të na japë edhe një porosi: “Historia e heroit tonë kombëtar Gjergj Kastrioti-Skënderbeut, duhet të studiohet e të njihet mirë nga brezi i ri, historia e të cilit duhet të shërbejë si burim frymëzimi për çdo shqiptar, për të ruajtur të pastra idealet tona atdhetare”.

Ashtu si autori, edhe unë mbetem me shpresë se, kjo porosi e shenjtë, do të dëgjohet nga institucionet shkencore, Akademia Shqiptare e Shkencave, drejtuesit e shtetit dhe mësuesit, si “Misionarë të dijes dhe edukimit” në shkollë.

Urime dhe suksese në udhën e mundimshme të studimit dhe botimit të librave të tillë. Janë vlera kombëtare.

**Kadri Tarelli**

**E**shtë e para herë që ndeshem me një libër të tillë, “Gjergj Kastrioti Skënderbeu në pullat shqiptare 1913 – 2023”. Më saktë, me krijimtarinë e studiuesit Hysen Dizdari, koleksionist i pasionuar i pullave, njëkohësisht edhe autor i disa librave studimor, ku si lëndë e parë shërbejnë pullat postare.

Një formë dhe gjetje interesante si studim dhe krijimtari, aq sa mrekullohem për talentin dhe guximin e këtij autori, i cili është vlerësuar këtu dhe në botë.

Më duhet të them se koleksionistët janë një “racë” e veçantë dhe e çuditshme. Kam njohur koleksionistë pullash, pikturash, monedhash, flamujsh, etj, etj. Por Hysen Dizdari nuk mbetet deri këtu, fanatik dhe i mbyllur në vetvete me “Thesarin” e tij, për t’u kënaqur vet dhe një grup miqsh e shokësh të dashuruar me koleksionet. Ai merr mundimin, studion e boton, duke e bërë frymën dhe punën e tij, pronë të gjithë shoqërisë shqiptare. Ndaj meriton adhurim e mirënjohje.....!

I thjeshtë titulli i këtij shkrimi kushtuar librit, apo albumit në shqip dhe anglisht, “Gjergj Kastrioti-Skënderbeu në pullat shqiptare 1913 – 2023”, siç janë të gjithë shkrimet që i kushtohet veprave shkencore. Është një libër i veçantë, si nga paraqitja ashtu edhe nga përmbajtja: - “Ta studioj dhe njoh historinë e Shtetit Shqiptar nëpërmjet historisë të pullave postare, jo pak por rreth 150 pamje”, kumton Thimi Nika, autori i librit “Historia e Filatelisë Shqiptare”. Pse ta mohoj, studimi i këtij libri është befasi, diçka krejt e re për mua, mbase edhe për shumë të tjerë.

Ky libër shfletohet si një album, por në brendësi të faqeve gjejmë që në krye poezi të Naim Frashërit, “Porosi e Skënderbeut për Shqiptarët”, shkëputur nga “Historia e Skënderbeut”. Ide mjaft e bukur, sepse përcillet kumti i bashkimit, si shqetësim i përhershëm i intelektualëve shqiptar. Më tej hasim, jo vetëm praktikën e shtypjes, kohën e përdorimit, çmimin, ngjyrat dhe sasinë e pullave në ecurinë e shtetit Shqiptar, por edhe sa kohë janë përdorur, duke vënë vula zyrtare, diku-diku edhe të postave lokale.

Dikush mund të mendojë dhe të pyesë: - Pullat janë thjesht formë legale e kontrollit dhe taksës që vendos

shteti mbi qarkullimin e letrave dhe mallrave, apo më shumë se kaq.....? – Po.....! Më shumë se kaq. Pullat janë dokument historik i pastër, pasi ka vulën e shtetit dhe vulën e kohës, duke fiksuar historinë e shtetit në një formë tjetër, një copë histori e njohur, e prekur dhe përkëdhelur nga publiku.

Lexuesi mund të mrekullohet ashtu si unë, kur shikon në faqet e para portretin e Skënderbeut, nga pulla e vitit 1913, në sixhade, punuar mjeshtërisht nga artizanët e Kukësit, më 2017. Nëse dikush është vërtet i kujdesshëm, do të hasë edhe historinë e këtij portreti, që në përgjithësi ka mbizotëruar pullat shqiptare për një kohë mjaft të gjatë. Të gjitha veprimet, vulat apo mbishtypjet e pullave, janë fare normale për kohën e trazirave të mëdha të luftës së Parë botërore (1914–1918), përfshi edhe lëvizjet dhe kryengritjet, siç ishte ajo e Haxhi Qamilit, që luftonte kundër “Mëvetësisë”.

Kyqyrni me kujdes: gjashtë pulla, ku vlera e tyre shkruhet turqisht, “Grosh” dhe “Para”. E gjitha pasojë e lajthitjes së lëvizjes antishqiptare, për të mos u shkëputur nga perandoria osmane. Dëshmi që vulos historinë, pa lënë shteg për mëdyshje. Natyrisht në rrjedhën e kohës dhe qeveritë ndër vite, bënë ndryshime në paraqitjen e pullave, pa prekur thelbin dhe karakterin atdhetar. Diku u vendosën armët e Skënderbeut, shpata dhe përkrenarja, diku vetëm shqiponja apo koka e kalit, diku kështjellat që mbronin dheun e shqiptarëve, etj.

Edhe gjatë periudhës së sistemit komunist, u përdorën disa variante pullash: portret, foto e Monumentit të Skënderbeut në Krujë, (Unë e vlerësoj si vepra më e arrirë artistikisht), më pas monumenti në qendër të Tiranës, pikturat në muzeun e Krujës, madje edhe piktura të autorëve të huaj, (E. Delakrua), mes tyre edhe piktorë anonim.

Interesant pasi nuk mungojnë edhe krijime artistike, portrete vajzash shqiptare me veshje kombëtare, vegla muzikore, si lahuta, etj, të cilat bukurmirë i bëjnë jehonë historisë së lavdishme të heroit tonë kombëtar, Skënderbeut dhe historisë sonë kombëtare.

Në këtë udhëtim mendimi, po më pëlqen pulla e prodhuar në vitin 2014, e titulluar “Papa Françesku në Shqipëri”, ku në plan të parë është portreti i Papa Françeskut, ndërsa në sfond paraqitet monumenti i Skënderbeut, vendosur në sheshin qendror të Tiranës.

## SUPLEMENTI LETRAT



# “Fatmir Gjata, shkrimtari me gjurmë të pashlyera në letërsinë Shqipe

shqiptare. Por kontributi i tij i vyer përfshin edhe autorësinë e skenarëve të disa filmave artistikë, dokumentarëve dhe pjesëve teatrale, ndër të cilat edhe skenari i “Tanës”, filmit të parë artistik shqiptar. Poet i vargjeve të këngëve më të njohura partizane si “Hakmarrje rini”, “Ato maja rripa-rripa”, “Plaku dhe i Riu”, “Kënga e Partizanit Benko” etj. Shkrimtar i shquar e popullor i dhjetëra romaneve, drama, vëllimeve me novela, tregime, vjersha e kujtime, ndër të cilat spikasin “Kënetë”, “Tana”, “Armiqtë” e “Këshilltarët”, “Permbysja”, “Fillim pranvere”, “Brezat”, “Uji fle hasmi s’fle” etj. Gjata e realizoi krijimtarinë e tij larg akademizmave e fryrjeve, duke u shndërruar në një nga autorët më prodhimtarë e të lexuar të dekadave të viteve ’50-’90. I botuar në disa gjuhë të huaja, Gjata është një ndër autorët më të njohur edhe në hapësirën mbarëshqiptare. Veprat e tij kryesore janë botuar që herët edhe në Kosovë nga shtëpia botuese “Rilindja”.



**L**indi në Korçë ne 22 shtator 1922. Ai kujtohet nga miqtë, të afërmit dhe dhjetëra mijëra lexues brenda dhe jashtë vendit si poeti partizan, këngëtar i zjarrtë i vargjeve që ngritën peshë luftëtarët: “Hakmarrje rini/dëshmori thërret/që ra për liri/mbi truallin e vet”.

I diplomuar në Liceun Francez të qytetit të Korçës dhe më pas në Institutin Gorki në Moskë, Fatmir Gjata është një nga eksponentët kryesorë të letërsisë shqiptare të realizmit socialist.

Vargjet e këngëve të luftës nacional-clirimtare do të mjaftonin për t’i dhënë Fatmir Gjatës një vend nderi në panteonin e letrave dhe të kulturës

Fatmir Gjata njihet gjithashtu për kontributin në krye të disa institucioneve të rëndësishme të artit dhe të kulturës shqiptare si Kryetar i Komitetit të Kulturës dhe Arteve, anëtar i kryesisë së Lidhjes së Shkrimtarëve dhe artistëve të Shqipërisë, kryeredaktor, përreth njëzet vjet me radhë i revistës së vetme letrare “Nëntori”, si gazetar dhe anëtar i kolegjumit të shumë organeve kryesore të shtypit shqiptar, si

“Zëri i Popullit”, “Drita”, “Ylli”, “Hosteni”, etj.

Shumë nga veprat e tij janë nderuar me cmime në konkurse kombetare e ndërkombëtare, si Cmimi i Parë i Republikës, Urdhri i Flamurit i Klasit të parë, etj. Këngët e tij janë kënduar nga një brez i tërë, një pjesë e të cilit tani nuk është; breza nxënësish, studentësh e të rinjsh njohën në shkollë veprat e shkrimtarit; një popull i tërë krijoi respekt për veprën e tij.

## Tekste të këngëve partizane nga shkrimtari Fatmir Gjata

### Rini Rini

Rini, rini përpara ti!  
Si dielli shkrep e vetëti,  
si zjarr rrufeje para shko,  
për vatër e nder, rini, lufto!

Lufto armik  
Lufto barbar,  
me trimëri  
porsi shqiptar,  
lufto, lufto,  
ti robërinë,  
fito atdhenë,  
fito lirinë!

### Kushtrimi

Që nga gjokset djaloshare  
Del kushtrimi shqipëtar,  
ngrihen grushte, hapen varre,  
për fashizmin gjakatar.

Zëri i pushkës me furi  
Po buçet sot anembanë,  
se luftojnë për liri  
shokët tanë partizanë.

### Plaku dhe i riu

Po i thotë plaku:”Shko!  
Atje tej, në mal, lufto!  
Gjith’ rinia po të thurret,  
gjith’ rinia po të pret  
që ka zjarrin m’u në gji,  
që derdh gjakun për liri.  
Nisu biro, mos përto,  
rrëmbe armët, vendin mbro!”

“Do të shkoj, se jam shqiptar  
E do djeg me flakë e zjarr,  
Do ta bëj unë shkumb e hi  
Të mallkuarën robëri...  
Dhe atje mbi shkëmb e gur  
Do të ngre t’kuqin flamur,  
E në u vrafsha do thërres:  
Për liri, unë po vdes!”

### Hakmarrje

Po ngrihet një zë nga fundi i varrit  
Si dielli kur shkrep e hapet mbi dhe:  
“Hakmarrje, hakmarrje, në grykë barbarit, -  
Përpara o popull, mbi të si rrufe!”

“Hakmarrje rini!,  
dëshmori thërret,

ai ra për liri  
mbi truallin e vet.

### Ato maja rripa-rripa

Ato maja rripa-rripa seç gjëmojnë,  
ndizet lufta për liri e derdhet gjak,  
janë trimat partizanë që luftojnë,  
janë bijt’ e Shqipërisë që marrin hak.

Sot po dridhet tirania anembanë,  
sot po digjet e po bëhet shkumb e hi,  
se u mbushën malet plot me partizanë,  
se u ngrit sot gjith’ rinia për liri.  
1942

### MARATONOMAKU

Dëshmorit Kristo Isak

Në burg të lidhur me zinxhirë,  
Xhelati s’ të përkuli dot,  
Këputë prangat n’errësirë  
Dhe shokëve u dole zot.  
Në zjarr e flak’ me trimëri  
Në Dardhën tënde derdhe gjak,  
vrapove drejt lirisë ti,  
o Kristo, maratonomak!  
1943

## MOZAIK



## GËZUAR VITIN E RI

2026!

*Kryesia e OBVLK uron të gjithë veteranët e LANÇ, pasardhësit dhe familjet e tyre për sa më shumë begati dhe lumturi gjatë vitit 2026. Nderim dhe respekt për heronjtë e dëshmorët e rënë në lufrat për pavarësinë e lirinë së Shqipërisë sonë të dashur. Mirënjohje për të gjithë ata që dhanë kontributin e tyre për evidentimin dhe promovimin e vlerave të LANÇ. Së bashku le të programojmë dhe përballojmë me dinjitet sfidat e reja.*

